REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 242 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 10.02.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, dhe kërkesës së datës 07.02.2022, nxjerr:

**V E N D I M**
**Për caktimin e zyrtarit/es**

1. **Z. Sami Gjuka, Koordinator i Logjistikës**, i jepet qasja në Sistemin e SIMFK-së në modulin e pranimit të mallit, në nivel të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Kodi organizativ 208, Kodi i programit 97400.

2. I lartëpërmenduri me qasjen për pranim të mallit e posedon që ta bëjë regjistrimin e pranimit të mallit në SIMFK, për vitin 2022.

3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë si dhe kërkesës së datës 07.02.2022 për dhënie të qasjes në sistemin e SIMF-së, për modulin pranim të mallit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Vendimi u dërgohet:**

1. Sami Gjuka,
2. Zyrës për Burime Njerëzore,
3. Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm,
4. Arkivit.

Tirana Baftiiu – Hasani
U.d. Sekretar i Përgjithshëm

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 243 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 10.02.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, dhe kërkesës së datës 07.02.2022, nxjerr:

# V E N D I M
## Për caktimin e zyrtarit/es

1. **Znj. Njomëza Haxhiu, zyrtare për të Hyra**, i jepet qasja në Sistemin e SIMFK-së në modulin e të hyrave, në nivel të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Kodi organizativ 208, Kodi i programit 97400.

2. E lartëpërmendura me qasjen për të hyra e posedon që ti regjistrojë të gjitha të hyrat në SIMFK, për vitin 2022.

3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë si dhe kërkesës së datës 07.02.2022 për dhënie të qasjes në sistemin e SIMF-së, për modulin e te hyrave, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Vendimi u dërgohet:**

1. Njomëza Haxhiu,
2. Zyrës për Burime Njerëzore,
3. Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm,
4. Arkivit.

Tirana Baftiiu – Hasani
U.d. Sekretar i Përgjithshëm

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 244 | Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 10.02.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, dhe kërkesës së datës 07.02.2022, nxjerr:

## VENDIM
### Për caktimin e zyrtarit/es

1. **Z. Muhamet Muriqi,** zyrtar për Shpenzime, i jepet qasja në Sistemin e SIMFK-së në modulin për shpenzime, në nivel të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Kodi organizativ 208, Kodi i programit 97400.

2. I lartëpërmendura me qasjen për shpenzime ka mundësinë të bëjë regjistrimin e kuponëve të shpenzimit në SIMFK, për vitin 2022.

3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë si dhe kërkesës së datës 07.02.2022 për dhënie të qasjes në sistemin e SIMF-së, për modulin e shpenzimeve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Vendimi u dërgohet:**

1. Muhamet Muriqi,
2. Zyrës për Burime Njerëzore,
3. Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm,
4. Arkivit.

Tirana Baftiu – Hasani
U.d. Sekretar i Përgjithshëm

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 245 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Date / Datum / Date 10.02.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, dhe kërkesës së datës 07.02.2022, nxjerr:

**V E N D I M**
**Për caktimin e zyrtarit/es**

1. **Z. Dukagjin Bukleta, zyrtar Çertifikues**, i jepet qasja në Sistemin e SIMFK-së në modulin për çertifikues/aprovues e SIMFK-së, në nivel të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Kodi organizativ 208, Kodi i programit 97400.

2. I lartëpërmenduri me qasjen për çertifikues/aprovues ka mundësinë të bëjë aprovimin e kuponëve të shpenzimeve në SIMFK, për vitin 2022.

3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë si dhe kërkesës së datës 07.02.2022 për dhënie të qasjes në sistemin e SIMF-së, për modulin Certifikues/aprovues, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Vendimi u dërgohet:**

1. Dukagjin Bukleta,
2. Zyrës për Burime Njerëzore,
3. Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm,
4. Arkivit.

Tirana Baftiju – Hasani
U.d. Sekretar i Përgjithshëm

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 246 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 10.02.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, dhe kërkesës së datës 07.02.2022, nxjerr:

## VENDIM
### Për caktimin e zyrtarit/es

1. **Z. Driton Fetaj,drejtor i Prokurimit**, i jepet qasja në Sistemin e SIMFK-së në modulin e blerjeve, në nivel të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Kodi organizativ 208, Kodi i programit 97400.

2. I lartëpërmenduri me qasjen për modulin e blerjeve e ka mundësinë të bëjë regjistrimin e urdhër blerjeve në SIMFK, për vitin 2022.

3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë si dhe kërkesës së datës 07.02.2022 për dhënie të qasjes në sistemin e SIMF-së, për modulin e blerjeve, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Vendimi u dërgohet:**

1. Driton Fetaj,
2. Zyrës për Burime Njerëzore,
3. Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm,
4. Arkivit.

Tirana Baftiiu – Hasani
U.d. Sekretar i Përgjithshëm

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 247 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date: 10 02 2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, dhe kërkesës së datës 07.02.2022, nxjerr:

**VENDIM**
**Për caktimin e zyrtarit/es**

1. **Z. Armend Alimusaj,** zyrtar për Paga, i jepet qasja në Sistemin e SIMFK-së në modulin për shpenzime (alternativ), në nivel të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Kodi organizativ 208, Kodi i programit 97400.

2. I lartëpërmenduri me qasjen për shpenzime ka mundësinë të bëjnë regjistrimin e kuponëve të shpenzimeve në SIMFK, për vitin 2022.

3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë si dhe kërkesës së datës 07.02.2022 për dhënie të qasjes në sistemin e SIMF-së, për modulin e shpenzimeve, u vendos si në dispozita të këtij vendimi.

**Vendimi u dërgohet:**

1. Armend Alimusaj,
2. Zyrës për Burime Njerëzore,
3. Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm,
4. Arkivit.

Tirana Baftiju – Hasani
U.d. Sekretar i Përgjithshëm

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 248 | Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 10.02.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

---

Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, dhe kërkesës së datës 07.02.2022, nxjerr:

**V E N D I M**

**Për caktimin e zyrtarit/es**

1. **Znj. Leonita Gruda,** zyrtar për Asete, i jepet qasja në Sistemin e SIMFK-së në modulin për pasuri në nivel të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Kodi organizativ 208, Kodi i programit 97400.

2. E lartëpërmendura me qasjen për pasuri ka mundësinë të bëjë regjistrimin e të gjitha pasurive që i posedon Universiteti "Haxhi Zeka" në SIMFK, për vitin 2022.

3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë si dhe kërkesës së datës 07.02.2022 për dhënie të qasjes në sistemin e SIMF-së, për modulin e pasurive, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Vendimi u dërgohet:**

1. Leonita Gruda,
2. Zyrës për Burime Njerëzore,
3. Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm,
4. Arkivit.

Tirana Baftiu – Hasani
U.d. Sekretar i Përgjithshëm

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI UNIVERZITET HAXHI ZEKA PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 279 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 15.02.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Datë: 15.02.2022

Duke u në bazuar në nenin 59 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 04/L-042, për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, nenin 183 të Statutit Nr. 04 – V – 662 të Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë, si dhe duke u bazuar në nenin 40 të Rregullores për Prokurimin Publik AU01, Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) i Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë (UHZ) në bashkëpunim me Drejtorin e Departamentit të Prokurimit, nxjerr këtë:

## VENDIM

I. Mbi themelimin e Komisionit Vlerësues për tenderin **Renovimin e banjove në Objektin C në Fakultetin e Biznesit dhe Fakultetin e MTHM-së** - Nr. i prokurimit: **uhz-22-553-5-5-6,**, në përbërje të:

1. Muhamet Muriqi - Zyrtar shpenzues në UHZ / Kryetar;
2. Veton Jahmurataj – Drejtor për Bibliotek në UHZ / Anëtar;
3. Meriton Fetaj - Zyrtar për çështje studentore në UHZ/ Anëtar;

II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Departamenti i Prokurimit i UHZ-së më datë 15.02.2022, ka hapur ofertat lidhur me njoftimin e shpallur për kontratë për tenderin me titull: **Renovimin e banjove në Objektin C në Fakultetin e Biznesit dhe Fakultetin e MTHM-së** - Nr. i prokurimit: **uhz-22-553-5-5-6.**

Detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë e komisionit janë të përcaktuara në nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik A01, ku të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësishtë dispozitave të LPP në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.

Zyrtari i Prokurimit dhe/ose anëtarët e stafit përgjegjës të Departamentit të Prokurimit, sipas nenit 16 të Rregullores për Prokurimin Publik A01, nuk do të shërbejnë si anëtarë të komisionit vlerësues. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit do të udhëheq komisionin vlerësues të tenderit pa të drejtë vote. Ai/ajo do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Shqyrtimi i Bazës Ligjore:**

- Ligji Nr. 02/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092;
- Rregullorja për Prokurimin Publik A01;

U.D. Sekretare e Përgjithshme
LL.M. Tirana Baftiu Hasani

B.Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** U.d. Sekretares së Përgjithshëm, Drejtorit të Prokurimit, Anëtareve të Komisionit Vlerësues, Asistentes së Rektorit, Arkivit të Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 291 | Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date: 18.02.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Pejë, 18.02.2022

Në bazë të nenit 41 të Statut të Universitetit "Haxhi Zeka " në Pejë, nenit 6 paragrafi 6.1.2. të Rregullores nr. 414 për përshkrimin e vendeve të punës në administratën e UHZ-së, si dhe me qëllim të caktimit të personit përgjegjës për punë shtesë për pozitën e zyrtarit për diploma , nxjerr këtë:

**VENDIM**

I. **Autorizohet: znj.** Valbona Luta – Drejtor për çështje studentore në Administratën Qendrore të UHZ-së, që përveç detyrave të parapara si Drejtor për çështje studentore, si punë shtesë t'i kryej edhe detyrat e parapara sipas nenit 6.1.2. të me Rregulloren nr. 414 për përshkrimin e vendeve të punës në administratën e UHZ-së.

II. Vendimi është i vlefshëm deri në plotësimin e pozitës së zyrtarit për diploma .

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Për shkak të pezullimit ( vendimi nr. 3462 dt.24.12.2021) të përkohshëm nga marrëdhënia e punës së nëpunësit Qemajl Sejdija/ Zyrtar për Diploma në Administratën Qendrore të UHZ-së, e lartpërmendura si punë shtesë do t'i kryej edhe detyrat e parapara me përshkrimin e vendit të punës sipas nenit 6 paragrafi 6.1.2. të Rregullores nr. 414 për përshkrimin e vendeve të punës në administratën e UHZ-së, deri në plotësimin e pozitës së zyrtarit për diploma.

Andaj, me qëllim të rritjes së efikasitetit të shërbimit të administratës dhe ngritjes së nivelit të shërbimit për studentë, duke pasur parasysh edhe nivelin e përgjegjësisë që ka e lartpërmendura është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

U.d. Sekretare e Përgjithshme

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

THasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurës, Rektorit, U.d. Sekretarit të Përgjithshëm, Menaxheres së Burimeve Njerëzore dhe Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 303 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Date / Datum / Date: 18.02.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**Dt. 18.02.2022**

Në mbështetje të nenit 38 paragrafit 3 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2. dhe nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe vendimin nr. 297 dt. 18.02.2022 për lejimin e pushimit të lehonisë për Era Mujaj/ Sekretare e Fakultetit Juridik, nxjerrë këtë:

## VENDIM

I. Nëpunësja Znj. Fatmire Thaçi e cila aktualisht është Zyrtare për çështje juridike në Fakultetin e MTHM-së, sistemohet përkohësisht në pozitën e Sekretares së fakultetit në njësinë akademike-Fakultetin Juridike në UHZ-së .

II. E lartëcekura është e obliguar që t'i përmbushë të gjitha të drejtat dhe detyrimet si Sekretare e fakultetit, sipas përshkrimit të vendit të punës të parapara me Rregulloren nr.247/20 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në UHZ-së.

III. Të gjitha kompetencat, përgjegjësit dhe benificionet e parapara me përshkrimin e vendit të punës të Sekretares së Fakultetit Juridik, gjatë ushtrimit të pozitës së lartëcekur kalojnë tek. Znj. Fatmire Thaçi.

IV. E lartëcekura detyrën do ta ushtrojë nga dt. 21.02.2022 deri në marrjen e ndonjë vendimi tjetër.

V. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

## ARSYETIM

Duke u bazuar në vendimin nr. 297 dt. 18.02.2022 për lejimin e pushimit të lehonisë për Sekretaren e Fakultetit Juridik znj. Era Mujaj, faktin se as një nga zyrtarët e fakultetit juridik nuk janë jurist me profesion dhe detyrat e këtij pozicioni nuk mund të mbulohen nga asnjë zyrtar i fakultetit juridik, si dhe aktivitetet tjera të administratës që ndërlidhen me këtë proces e bëjë të pa mundur menaxhimin e administratës të kësaj njësie akademike, me qëllim që procesi i punës në këtë njësi akademike të vazhdojë normalisht dhe pa ngecje, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**LL.M. Tirana Baftiu Hasani – U.d. Sekretare e Përgjithshme/ UHZ-së**

**Nënshkrimi** _B.Hasani_

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurës, U.d. Sekretares së Përgjithshëm, Dekanit të FakultetitJuridik, Sekretares së njësisë Fakultetit Juridik, Departamentit për Buxhet dhe Financa, Zyrtarit për paga, Menaxheres së Burimeve Njerëzore, Kryesuesit për teknologji të informacionit, Udhëheqësit të Sektorit të Arkivit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 322 | Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date 24.02.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Pejë, 24.02. 2022

Në bazë të nenit 41 të Statutit nr.04-v-622 të UHZ-së, nenit 41 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Vendimit nr. 118-22-19131/2022 të Kryetarit të Komunës së Pejës, si dhe kërkesës nr. 316/22 dt. 24.02.2022, U.d. Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit "Haxhi Zeka ", nxjerr këtë:

## VENDIM

I. Aprovohet si e bazuar kërkesa nr. 316/22 dt. 24.02.2022, e z. Agron Halitaj për kthimin në punë në pozitën e njejtë, Zyrtar për Buxhet dhe Financa në NA/ Fakulteti i Biznesit në UHZ.

II. I lartëcekura kthehet në punë te punëdhënësi gjegjësisht në Njësinë Akademike / Fakulteti i Biznesit që nga dt. 25.02.2022.

III. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Pas shqyrtimit të kërkesës nr. 316/22 dt. 24.02.2022, të z. Agron Halitaj për kthimin në punë në pozitën e njejtë, Zyrtar për Buxhet dhe Financa në NA/ Fakulteti i Biznesit në Universitetin "Haxhi Zeka " në Pejë, vendimit nr. 118-22-19131/2022 të Kryetarit të Komunës së Pejës, me të cilën i lartpërmenduri lirohet nga pozita e Drejtorit të Drejtorisë për Inspektorat nga dt. 23 shkurt 2022, si dhe duke marrë parasysh neni 41 paragrafi 2 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, në të cilin parashihet se i punësuari pas pushimit të të drejtave të punës kur zgjidhet apo emërohet në funksione publike, ka të drejtë të kthehet te punëdhënësi brenda afatit prej pesë (5) ditësh, konstatoi se kërkesa e të lartpërmendurit është e drejtë dhe e bazuar në gjendjen faktike.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

U.d. Sekretare e Përgjithshme e Universitetit

LL.M. Tirana Baftiu – Hasani

B.Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurit, Rektorit, Dekanit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Sekretarit të njësisë akademike, Menaxheres së Personelit, Drejtorit për buxhet dhe financa, Zyrtarit për paga, Arkivit të Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 554 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date 14.03.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Pejë, 14.03.2022.

Në bazë të nenit 41 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, Listës së kandidatëve për zgjedhjet për Parlament studentor të UHZ-së nga Organizata studentore Reforma Studentore "Haxhi Zeka", si dhe certifikatës së diplomimit nr.986 dt.16.09.2021 të Arian Jeton Berbati ,nxjerr këtë:

**V E N D I M**

I. Me rastin e diplomimit studentit Arian Jeton Berbati **i ndërpritet mandati** i fituar anëtar në parlamentin studentor të UHZ-së, nga Organizata studentore Reforma Studentore "Haxhi Zeka" .

II. Mandati i mbetur vakant plotësohet me kandidatin e radhës të renditur në listën e çertifikuar të kandidatëve.

III. Mandati i mbetur vakant sipas listës së çertifikuar të kandidatëve i takon kandidatit Flamur Berisha student në Fakultetin e Agrobiznesit.

IV. Mandati i mbetur vlen nga dt. 15.03.2022 deri me dt. 30.09.2023.

V. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

U.d. Sekretare e Përgjithshme e UHZ- së.

LL.M.Tirana Baftiu Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Studentit Flamur Berisha, Adonis Kelmendi, Ilir Idrizaj, Rektorit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Arkivit të UHZ-së.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 559 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 15.03.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**Pejë, 15.03.2022**

Në bazë të nenin 41 të Statutit të Universitetit " Haxhi Zeka" në Pejë, si dhe me qëllim të caktimit të personit përgjegjës për punë shtesë i cili autorizohet që të nënshkruaj dokumentet për ish studentët e ish SHLE-s dhe ish FSHAB, e nxjerr, këtë:

**VENDIM**

**I. Autorizohet:**

Liridon Cukaj – Sekretar i njësisë akademike / Fakulteti i Biznesit, që përveç detyrave të parapara si Sekretar i Njësisë Akademike, si punë shtesë t'i nënshkruaj edhe dokumentet ( çertifikatat, vërtetimet, etj) , për ish studentët e ish SHLE-s dhe ish FSHAB.

**II.** Kërkohet nga i lartëpërmenduri që nënshkrimi i certifikatave, vërtetimeve etj, të bëhet vetëm pas verifikimit të të dhënave dhe rrjedhimisht të mbajnë përgjegjësi të plotë për verifikimin.

**III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Për shkak të mungesës së personi përgjegjës të ish zyrtares Anita Cucoviç në njësinë akademike / Fakultetin e Biznesit, e cila ka kaluar në stafin akademik nga dt. 16.02.2022, si dhe caktimit të personit përgjegjës për punë shtesë i lartpërmenduri autorizohet që të nënshkruaj dokumentet për ish studentët e ish SHLE-s dhe ish FSHAB, deri në plotësimin e pozitës së zyrtarit për çështje studentore.

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

U.d. Sekretare e Përgjithshme

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Dekanit të Fakultetit të Biznesit, Menaxheres së Burimeve Njerëzore, Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 624   Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 18.03.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**Pejë, 17.03.2022**

Në bazë të nenit 41 të Statut të Universitetit "Haxhi Zeka " në Pejë, nenit 8 paragrafi 8.1.6. të Rregullores nr. 414 për përshkrimin e vendeve të punës në administratën e UHZ-së, si dhe me qëllim të caktimit të personit përgjegjës për punë shtesë për pozitën e zyrtarit arkëtar , nxjerr këtë:

**VENDIM**

**I.** **Autorizohet: znj.** Abetare Pelaj – Zyrtare për buxhet dhe financa në Njësinë Akademike Fakultetin e Agrobiznesit që përveç detyrave të parapara si Zyrtare për buxhet dhe financa, si punë shtesë t'i kryej edhe detyrat e parapara sipas nenit 8.1.6. me Rregulloren nr. 414 për përshkrimin e vendeve të punës në administratën e UHZ-së.

**II.** Vendimi është i vlefshëm deri në plotësimin e pozitës së arkëtarit .

**III.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Duke pasur parasysh se detyrat e këtij pozicioni nuk janë të mbuluara aktualisht nga asnjë zyrtar, e lartpërmendura si punë shtesë do t'i kryej edhe detyrat e parapara me përshkrimin e vendit të punës sipas nenit 8 paragrafi 8.1.6. të Rregullores nr. 414 për përshkrimin e vendeve të punës në administratën e UHZ-së, deri në plotësimin e pozitës së arkëtarit.

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

U.d. Sekretare e Përgjithshme

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

B.Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurës, Rektorit, Prorektores për buxhet dhe financa, U.d. Sekretares ë Përgjithshëm, Drejtorit për buxhet dhe financa, Menaxheres së Burimeve Njerëzore, Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 646 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 2
Data / Datum / Date 21.03.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Dt. 21.03.2022

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, dhe kërkesës së datës 03.02.2022, nxjerr:

## V E N D I M
### Për caktimin e zyrtarit/es - Alternativ

1. **Z. Admirim Sahara**, i jepet qasja në Sistemin e SIMFK-së në modulin e pranimit të mallit (alternative), në nivel të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Kodi organizativ 208, Kodi i programit 97400.
2. Të lartëpërmendurit i ipet qasja për pranim të mallit që ta bëjë regjistrimin e pranimit të mallit në SIMFK, për vitin 2022.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## A r s y e t i m i

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë si dhe kërkesës së datës 03.02.2022 për dhënie të qasjes në sistemin e SIMF-së, për modulin pranim të mallit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

U.d. Sekretare e Përgjithshme
LL.M. Tirana Baftiu – Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Asistentes së Rektorit, Zyres për financa dhe buxhet, Zyrës për Burime Njerëzore, Arkivit të UHZ-së.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 653 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 22.03.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Pejë, 22.03.2022

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik , nenin 38 dhe 41 të Statutit të Universitetit " Haxhi Zeka" në Pejë, nxjerr, këtë:

**VENDIM**

I. **Autorizohet z.** Veton Jahmurataj – Drejtor i Bibliotekës, për udhëheqjen e aktivitetit të prokurimit me titull: Shërbime të transportit rrugor për nevojat e UHZ-së, Nr.i prokurimit:uhz-22-827-2-2-1 , deri në nënshkrimin e kontratës.

II. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Departamenti i prokurimit në UHZ është duke e zhvilluar aktivitetin e Prokurimit me titull: Shërbime të transportit rrugor për nevojat e UHZ - Nr. i prokurimit: uhz-22-827-2-2-1 , në bazë të kërkesës për inicimin e kësaj procedure nga njësia kërkuese.

Në këtë aktivitet, janë pranuar dy oferta nga Operatoret Ekonomik, ku njeri Operator Ekonomik ofertues ka mbiemrin Fetaj.

Duke mos dashur që të biem në kundërshtim me ligjin për konflikt të interesit lidhur me këtë aktivitet pasiqë z. Driton Fetaj si zyrtar përgjegjës i prokurimit dhe njeri nga Operatoret ekonomik Ofertues kanë të njëjtin mbiemër FETAJ, autorizoi z. Veton Jahmurataj, për udhëheqjen e kësaj procedure deri në nënshkrimin e kontratës.

z. Veton Jahmurataj, është i certifikuar nga Ministria e Administratës Publike (IKAP) në fushën e prokurimit siç e kërkon edhe legjislacioni.

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

U.d. Sekretare e Përgjithshme

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurit, Prorektores për buxhet, financa dhe inrtastruktur, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Drejtorit të Prokurimit, Kryesuesit të IT, Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 722 | Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date: 31.03.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

---

**U.d. Sekretar i Përgjithshëm** **Pejë: 31.03.2022**

Në bazë të nenit 38, 41 të Statutit të UHZ-së, nenit 57 të Ligjit për Zyrtarët Publikë Nr. 06/L-114, nenit 14 paragrafi 2.2 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për orarin e punës dhe pushimet e zyrtarëve publik, kërkesës së Zyrtares për çështje studentore Doruntina Avdijaj Hulaj me nr. prot. 703, dt: 29.03.2022 dhe rekomandimit të Udhëheqësit të drejtpërdrejtë të saj me Ref. Nr.714. të dt. 30.04.2022, U.d. Sekretari i Përgjithshëm nxjerrë këtë:

**VENDIM**

**I. Znj. Doruntina Avdijaj Hulaj**, Zyrtare për çështje studentore të nivelit bachelor në fakultetin Juridik, i lejohet pushimi pa pagesë prej dt. 14.04.2022 deri me 13. 04.2023.

**II.** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Pas shqyrtimit të kërkesës së Doruntina Avdijaj Hulaj, Zyrtare për çështje studentore të nivelit bachelor në fakultetin Juridik, për marrjen e pushimit pa pagesë për të u kujdesur për tre fëmijët e saj të vegjël dhe për vjehrrën e sëmurë rëndësi si dhe duke u bazuar në ligjshmërinë e lartcekur U.d. Sekretari i Përgjithshëm vendosi të aprovoi kërkesën e Znj. Doruntina Avdijaj Hulaj për lejimin e pushimit pa pagesë si në dispozitiv të këtij vendimi.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

BHasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
"Universiteti Haxhi Zeka"- Pejë

**Vendimi t'iu dërgohet**: nëpunëses Znj. Doruntina Avdijaj Hulaj, Zyrës së Rektorit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Menaxherit të Burimeve Njerëzore, Departamentit për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 831 | Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 15.04.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Në mbështetje të nenit 38 paragrafit 3 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, dhe nenit 17 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nxjerrë këtë:

**VENDIM**

I. Nëpunësi z. Berat Gegaj i cili aktualisht është Zyrtar për çështje studentore në njësinë akademike/ Fakultetin Juridik në UHZ-së, sistemohet në pozitën Zyrtar për çështje studentore në njësinë Akademike / Fakultetin e Agrobiznesit.

II. I lartëcekuri është i obliguar që t'i përmbushë të gjitha të drejtat dhe detyrimet si Zyrtare për çështje studentore sipas përshkrimit të vendit të punës të parapara me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në UHZ-së.

III. Vendimi është i vlefshëm deri me dt. 17.05.2022.

IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Për shkak të ristrukturimit të punës në Fakultetin e Agrobiznesit dhe duke pasur parasysh se në Fakultetin e Agrobiznesit, ka nevojë për një Zyrtar për çështje studentore në mënyrë që procesi i punës në këtë njësi akademike të bëhet në mënyrë permanente dhe pa ngecje, sistemimi i nëpunësit z. Berat Gegaj i cili aktualisht është Zyrtar për çështje studentore në njësinë akademike/ Fakultetin Juridik në UHZ-së, bëhet në pozitën Zyrtar për çështje studentore në Njësinë Akademike - Fakultetin e Agrobiznesit.

Sistemimi bëhet duke u bazuar në nenin 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ku citohet se : " Në rast të nevojës për ristrukturim apo organizim të ri të punës, i punësuari në pajtim me Kontratën Punës mund të sistemohet në vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale paftësisë së tij dhe nivelit të njëjtë të pagës, në pajtim me Kontratën e Punës", dhe që procesi i punës në këtë njësi akademike të bëhet në mënyrë permanente dhe pa ngecje.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**LL.M. Tirana Baftiu Hasani – U.d. Sekretare e Përgjithshme/ UHZ-së**

**Nënshkrimi** ____________

**Data 15/04/2022**

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurit, U.d. Sekretares së Përgjithshëm, Dekanit të Fakultetit Juridik, Dekanit të Fakultetit të Agrobiznesit, Sekretares së njësisë së Fakulteti Juridik, Sekretarit të njësisë së Fakultetit të Agrobiznesit , Departamentit për Buxhet dhe Financa, Menaxheres së Burimeve Njerëzore, Kryesuesit për teknologji të informacionit, Udhëheqësit të Sektorit të Arkivit.

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI / UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 845 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date: 19.04.2022 Pejë / Peć

**Vendimi Nr. 01/2022/ZKA / 19.04.2022**

Duke u bazuar në neni 41 paragrafi 1.2, 1.4, neni 183 të Statutin Nr. 04 -V - 662 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, nenit 68 paragrafi 4 dhe 7 të Ligjit nr. 06/L - 114 për zyrtarët publikë dhe nenin 7 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nxjerr këtë:

## VENDIM

**I.** Themelohet Komisioni Përzgjedhës ad-hoc për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën Zyrtar për çështje studentore, në Njësinë Akademike /Fakulteti Juridik, në përbërje si në vijim:

1. Znj. Fatmire Thaçi - U.d. Sekretare në Fakultetin Juridik/- Kryetare;
2. Znj. Valbona Luta - Drejtor për çështje studentore / Rektorat - anëtare;
3. Znj. Mandeta Hadërgjonaj – Drejtoresh për BNJ dhe BGJ /Rektorat - anëtare;
4. Z. Petrit Bajraktari – Zyrtar për çështje studentore / FMTHM - anëtar;
5. Znj. Afrodita Gashi – Zyrtare për buxhet dhe financa/ F. Juridik – anëtare.

**II.** Komisioni Përzgjedhës është përgjegjës për menaxhimin e vlerësimit, përgatitjen e listës së shkurtër, për caktimin e orarit të përzgjedhjes, përpilimin e testit, mbajtjen e testimeve sipas procedurës me shkrim, mbajtjen e Intervistës, vlerësimin e rezultateve dhe propozimin për listën përfundimtare përzgjedhëse për kandidatin e suksesshmen.

**III.** Mandati i Komisionit përzgjedhës përfundon me nxjerrjen e vendimit përfundimtar për përzgjedhjen e kandidatit .

**IV**. Vendimi hyn në fuqi ditë e nënshkrimit.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

Hasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi i dorëzohet:** Anëtarëve të Komisionit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Drejtoreshës së BNJ dhe BGJ Kyesuesit të TI dhe Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË — UNIVERSITETI / UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË — REKTORATI
Nr. / Br. / No. 846 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date: 19.04.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**Vendimi Nr. 02/2022/ZKA / 19.04.2022**

Duke u bazuar në neni 41 paragrafi 1.2, 1.4, neni 183 të Statutin Nr. 04 -V - 662 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, nenit 68 paragrafi 4 dhe 7 të Ligjit nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 7 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nxjerr këtë:

## VENDIM

**I.** Themelohet Komisioni Përzgjedhës ad-hoc për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën Zyrtar Ekzekutiv i Këshillit Drejtues në Rektorat, në përbërje si në vijim:

1. Znj. Tirana Baftiu Hasani - U.d. Sekretare e Përgjithshme e UHZ-së -Kryetare;
2. Z. Osman Sejfijaja - Drejtor i Administratës Qendrore / Rektorat -anëtar;
3. Znj. Mandeta Hadërgjonaj – Drejtoreshë për BNJ dhe BGJ /Rektorat -anëtare;
4. Z. Adnan Lataj – Drejtor i TI / Rektorat - anëtar;
5. Z. Veton Jahmurataj – Drejtor i Bibliotekës / F. Juridik – anëtar.

**II.** Komisioni Përzgjedhës është përgjegjës për menaxhimin e vlerësimit, përgatitjen e listës së shkurtër, për caktimin e orarit të përzgjedhjes, përpilimin e testit, mbajtjen e testimeve sipas procedurës me shkrim, mbajtjen e Intervistës, vlerësimin e rezultateve dhe propozimin për listën përfundimtare përzgjedhëse për kandidatin e suksesshmen.

**III.** Mandati i Komisionit përzgjedhës përfundon me nxjerrjen e vendimit përfundimtar për përzgjedhjen e kandidatit .

**IV.** Vendimi hyn në fuqi ditë e nënshkrimi.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

B.Hasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi i dorëzohet:** Anëtarëve të Komisionit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Drejtoreshës së BNJ dhe BGJ, Kyesuesit të TI dhe Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 847 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 19.04.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**Vendimi Nr. 04/2022/ZKA / 19.04.2022**

Në mbështetje të nenit 41 paragrafit 1 nën paragrafi 1.2. dhe 1.4. të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, nenit 53 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nxjerrë këtë:

## VENDIM

I. **Shfuqizohet** vendimi me nr. 1555 dt. 04.09.2020 për plotësimin dhe ndryshimin e Komisionit për zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë .

II. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

## ARSYETIM

Duke ju referuar nenit 53 paragrafit 1 dhe 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative shfuqizohet vendimi me nr. 1555 dt. 04.09.2020 për plotësimin dhe ndryshimin e Komisionit për zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë , me një akt të ri me shkrim, i cili shfuqizon aktin e parë.

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

Hasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi t'i dërgohet:** Besa Baloku, Diliko Kaçi, Agron Halitaj, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Drejtoreshës së BNJ dhe BGJ, Kryesuesit për Teknologji të Informacionit, Arkivit të Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 848 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date: 19.04.2022 Pejë / Peć

**Vendimi Nr. 03/2022/ZKA / 19.04.2022**

Duke u bazuar në neni 41 paragrafi 1.2, 1.4, neni 183 të Statutin Nr. 04 -V - 662 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, nenit 74 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1. të Ligjit nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, nenit 18 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, si dhe nenin 13 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nxjerr këtë:

**VENDIM**

**I.** Themelohet Komisioni për shqyrtimin e Ankesave për nëpunësit e shërbimit publik në kuadër të Universitetit " Haxhi Zeka " Pejë, në përbërje si në vijim:

1. Z. Ukë Selimaj - Sekretar i njësisë akademike - Kryesues;
2. Z. Armend Alimusaj - Zyrtar për paga - anëtar;
3. Znj. Mandeta Hadërgjonaj – Drejtoreshë për BNJ dhe BGJ – anëtare.

**II.** Komisioni emërohet për një mandat prej tre (3) vitesh.

**III.** Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit për shqyrtimin e ankesave nuk mund të jenë kryesues dhe anëtarë të komisionit disiplinor.

**IV.** Komisioni për shqyrtimin e Ankesave është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave sipas nenit 18 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

**V.** Të emëruarit janë përgjegjës që të ushtrojnë detyrat në pajtim me Ligjin nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren (QRK) nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, Udhëzimin Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publikë dhe legjislacionin në fuqi.

**VI.** Vendimi hyn në fuqi ditë e nënshkrimi.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi i dorëzohet:** Anëtarëve të Komisionit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Drejtoreshës së BNJ dhe BGJ, Kyesuesit të TI dhe Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 935 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date 28.04.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**Vendimi Nr. 05/2022/ZKA / 28.04.2022**

Në mbështetje të nenit 41 paragrafit 1 nën paragrafi 1.2. dhe 1.4. të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, nenit 53 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nxjerrë këtë:

**VENDIM**

I. **Shfuqizohet** vendimi me nr. 1554 dt. 04.09.2020 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit MP/24/2020, të Komisionit Disiplinor të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë .

II. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**ARSYETIM**

Duke ju referuar nenit 53 paragrafit 1 dhe 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative shfuqizohet vendimi me nr. 1554 dt. 04.09.2020 për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit MP/24/2020, të Komisionit Disiplinor të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, me një akt të ri me shkrim, i cili shfuqizon aktin e parë.

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

Hasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi t'i dërgohet:** Durim Hoxha, Mandeta Hadërgjonaj, Muhamet Jupa , U.d. Sekretares së Përgjithshme, Kryesuesit për Teknologji të Informacionit, Arkivit të Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë.

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 936 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 28.04.2022 Pejë / Peć

**Vendimi Nr. 05/2022/ZKA / 28.04.2022**

Duke u bazuar në neni 41 paragrafi 1.2, 1.4, neni 183 të Statutin Nr. 04 -V - 662 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, nenit 72 të Ligjit nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, nenit 17 të Rregullores (QRK) nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, nxjerr këtë:

**VENDIM**

**I.** Themelohet Komisioni Disiplinor për nëpunësit e shërbimit publik në kuadër të Universitetit " Haxhi Zeka " Pejë, në përbërje si në vijim:

1. Z. Petrit Bajraktari - Kryesues;
2. Z. Veton Jahmurataj - anëtar;
3. Z. Agron Halitaj – anëtar;
4. Znj. Diliko Kaçi – anëtare;
5. Znj. Valmira Abazi - anëtare.

**II.** Komisioni emërohet për një mandat prej tre (3) vitesh.

**III.** Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit për shqyrtimin e ankesave nuk mund të jenë kryesues dhe anëtarë të komisionit disiplinor.

**IV.** Komisioni Disiplinor është përgjegjës për zhvillimin e procedurave disiplinore dhe masat që shqiptohen sipas Rregullores (QRK) nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

**V.** Të emëruarit janë përgjegjës që të ushtrojnë detyrat në pajtim me Ligjin nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren (QRK) nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe legjislacionin në fuqi.

**VI.** Vendimi hyn në fuqi ditë e nënshkrimi.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi i dorëzohet:** Anëtarëve të Komisionit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Drejtoreshës së BNJ dhe BGJ, Kryesuesit të TI dhe Arkivit të Universitetit.

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË

REKTORATI

Nr./Br./No. 1229 Nr. i faq/Br. str/No. pg 1
Datum/Date: 09.06.2022 Pejë/Peć

Duke u bazuar në nenin 53 paragrafi 3 të Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe neni 41 të Statutin Nr. 04 -V - 662 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, nxjerr këtë:

**VENDIM**

**I.** Ndryshohet dhe plotësohet pika I me nr. 3 i Vendimit nr. 846 i dt. 19.04.2022, lidhur me themelimin e Komisioni Përzgjedhës ad-hoc për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën Zyrtar Ekzekutiv i Këshillit Drejtues në Rektorat.

**II.** Zëvendësohet anëtarja e komisionit Znj. Mandeta Hadërgjonaj – Drejtoreshë për BNJ dhe BGJ, dhe anëtare e re e këtij komisioni emërohet:

- Znj.Albana Belegu – Asistente e Dekanit / F.Juridik - anëtare

**III.** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Sipas pikës I me nr. 3 të Vendimit nr. 846 i dt.19.04.2022, lidhur me themelimin e Komisioni Përzgjedhës ad-hoc për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën Zyrtar Ekzekutiv i Këshillit Drejtues në Rektorat, në përbërje të këtij komisioni është edhe Znj. Mandeta Hadërgjonaj – Drejtoreshë për BNJ dhe BGJ.

Mirpo duke u bazuar në kërkesën për pushime nr. 1283 dt.06.06.2022, Znj. Mandeta Hadërgjonaj nga dt. 08. 06.2022 deri me dt. 30.06.2022 , është në pushim vjetor, andaj për shkak të mos ngecjes së procedurave të rekrutimit bëhet zëvendësimi me anëtare të re sipas pikës II të dispozitivit të këtij vendimi.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

U.d. Sekretore e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi i dorëzohet: znj.** Të lartpërmendurës, Anëtarëve të Komisionit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Kyesuesit të TI dhe Arkivit të Universitetit.

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 1330 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date: 09.06.2022 Pejë / Peć

Duke u bazuar në nenin 53 paragrafi 3 të Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe neni 41 të Statutin Nr. 04 -V - 662 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, nxjerr këtë:

## VENDIM

I. Ndryshohet dhe plotësohet pika I me nr. 3 i Vendimit nr. 845 i dt. 19.04.2022, lidhur me themelimin e Komisioni Përzgjedhës ad-hoc për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën Zyrtar për çështje studentore në Njësinë Akademike/ Fakulteti Juridik.

II. Zëvendësohet anëtarja e komisionit Znj. Mandeta Hadërgjonaj – Drejtoreshë për BNJ dhe BGJ, dhe anëtar i ri i këtij komisioni emërohet:

- Z. Veton Jahmurataj – Drejtor i Bibliotekës/ F. Juridik - Anëtar

III. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Sipas pikës I me nr. 3 të Vendimit nr. 845 i dt.19.04.2022, lidhur me themelimin e Komisioni Përzgjedhës ad-hoc për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën Zyrtar për çështje studentore në Njësinë Akademike/ Fakulteti Juridik, në përbërje të këtij komisioni është edhe Znj. Mandeta Hadërgjonaj – Drejtoreshë për BNJ dhe BGJ.

Mirpo duke u bazuar në kërkesën për pushime nr. 1283 dt.06.06.2022, Znj. Mandeta Hadërgjonaj nga dt. 08. 06.2022 deri me dt. 30.06.2022 është në pushim vjetor, andaj për shkak të mos ngecjes së procedurave të rekrutimit bëhet zëvendësimi me anëtar të ri sipas pikës II të dispozitivit të këtij vendimi.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi i dorëzohet: znj.** Të lartpërmendurit, Anëtarëve të Komisionit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Kyesuesit të TI dhe Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 1246 | Nr. i faq/ Br. str / No. pg 2

Data / Datum / Date: 31/05/2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

---

Në bazë të nenit 53 paragrafi 1 dhe 3, neni 55 paragrafi 1 dhe nenit 58 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 38 paragrafit 3 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, nxjerrë këtë:

## VENDIM

I. **Shfuqizohet** akt emërimi nr.2595 dt.08.10.2019 i nëpunëses Donika Kastrati me titull të vendit të punës Zyrtar për Bashkëpunim Ndërkombëtar kategoria funksionale P, Grada – Hapi /Uni 30.

II. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

## ARSYETIM

Sipas Akt emërimin nr.2592 dt.08.10.2019, znj. Donika Kastrati i caktohet titulli i vendit të punës Zyrtare për Bashkëpunim Ndërkombëtar kategoria funksionale P, Grada – Hapi /Uni 30, ku ngritja e gradës nga kategoria funksionale A në kategorin funksionale P, është bërë në kundërshtim me nenin 26 dhe 27 të Ligjin nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe dispozitat e Rregullores nr. 21/2012 për Avancimin në karrierë të nëpunësve civil.

Gjatë avancimit të znj. Donika Kastrati nuk janë marrë parasysh dispozitat e nenit 26 paragrafi 3 i Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovë, ku citohet se çdo avancim i cili është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji nuk është i lejueshëm, kurse në nenin 27 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4. të ligjit të lartcekur citohet se : avancimi nga një pozitë më e ulët në një pozitë më të lartë funksionale ose gradë, avancimi nga një pozitë më e ulët në pozitë më të lartë funksionale ose nga një gradë më e ulët në një gradë më të lartë brenda pozitës funksionale lejohet në bazë të: kalimit me sukses të testimit, dëshmimit të meritës, aftësive dhe kompetencës profesionale, duke përfshirë edhe dispozitat e nenit 27 paragrafi 2 , si dhe dispozitat e Rregullores nr. 21/2012 për Avancimin në karrierë të nëpunësve civil.

Andaj, avancimi i të lartpërmendurës sipas akt emërimi nr.2595 dt.08.10.2019 është bërë duke kaluar nga kategoria funksionale A në kategorinë funksionale P, e jo brenda të njëjtës kategori funksionale, në kundërshtim me nenet e lartëcekura të parapara me Ligjin nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të

Republikës së Kosovë dhe dispozitat e Rregullores nr. 21/2012 për Avancimin në karrierë të nëpunësve civil.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**LL.M. Tirana Baftiu Hasani – U.d. Sekretare e Përgjithshme/ UHZ-së.**

**Nënshkrimi** B.Hasani

**Data 31/05/2022**

---

**Vendimi t'i dërgohet :** Të lartpërmendurës, U.d. Sekretares së Përgjithshëm, Dekanit të F. Juridik, U.d. Sekretares së F.Juridik, Departamentit për Buxhet dhe Financa, Menaxheres së Burimeve Njerëzore dhe Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË

REKTORATI

Nr. Ref./No 1293 Nr. i fq. Br. str./No pg. 1
Data/Datum/Date 07 06 2022

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Pejë, 08.06.2022

Në bazë të nenit 41 të Statut të Universitetit "Haxhi Zeka " në Pejë, nenit 14 paragrafi 14.1 të Rregullores nr. 414/20 për përshkrimin e vendeve të punës në administratën e UHZ-së, si dhe me qëllim të caktimit të personit përgjegjës për punë shtesë për pozitën e Drejtorit për burime njerëzore dhe barazi gjinore , nxjerr këtë:

**VENDIM**

I. **Autorizohet: z. Osman Sejfijaj** – Drejtor i Administratës Qendrore të UHZ-së, në Rektorat që përveç detyrave të parapara si Drejtor i Administratës Qendrore, nga dt.08.06.2022 si punë shtesë t'i kryej edhe detyrat e parapara sipas nenit 14.1. me Rregulloren nr. 414/20 për përshkrimin e vendeve të punës në administratën e UHZ-së.

II. Vendimi është i vlefshëm deri në plotësimin e pozitës së Drejtorit për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Znj. Mandeta Hadërgjonaj me pozitë Drejtor për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore sipas kërkesës për pushime nr. 1283 dt.06.06.2022 nga dt. 08. 06.2022 deri me dt. 30.06.2022 është në pushim vjetor, kurse sipas kërkesës nr.1260 dt. 01.06.2022 znj. Mandeta Hadërgjonaj nga dt. 01.07.2022 jep dorëheqje nga pozita e Drejtorit për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore në Universitetitn "Haxhi Zeka" në Pejë, andaj për shkak se detyrat e këtij pozicioni nuk janë të mbuluara aktualisht nga asnjë zyrtar, sepse edhe zyrtarja e personelit Diliko Kaci Shala sipas vendimit nr.3221/21, për të drejtën e pushimit të lehonisë nga dt. 25.11.2021 deri me dt. 25.11.2022, është në pushim të lehonisë, autorizohet Drejtori i Administratës Qendrore të UHZ-së z. Osman Sejfijaj përveç detyrave të parapara si Drejtor i Administratës Qendrore, që nga dt.08.06.2022, si punë shtesë t'i kryej edhe detyrat e parapara me përshkrimin e vendit të punës sipas nenit 14 paragrafi 14.1. të Rregullores nr. 414/20 për përshkrimin e vendeve të punës në administratën e UHZ-së, deri në plotësimin e pozitës së Drejtorit për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore.

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

U.d. Sekretare e Përgjithshme

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurit,, Prorektores për buxhet dhe financa, U.d. Sekretares Së PërgjithshmE, Drejtorit për buxhet dhe financa, Menaxheres së Burimeve Njerëzore, Arkivit të Universitetit.

Adresa: Rr. "Eliot Engel' 30000, Pejë
www.unhz.eu; info@unhz.eu; Tel.; +381/39/432 491

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 1369 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date: 15.06.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**Datë: 14.06.2022**

Në mbështetje të nenit 12, të Udhëzimit Administrativ (MPMS) NR. 07/2017, Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Komisioni Përzgjedhës nxjerr:

# VENDIM

Për përzgjedhjen e aplikuesit **Rita Mazrekaj** - për vendin e punës Zyrtar Ekzekutiv i Këshillit Drejtues në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, e cili ka 169 pikë në listën definitive.

## Arsyetim

Komisioni përzgjedhës i themeluar nga U.d. Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit në bazë të vendimit nr. 841dt.19.04.2022, pas testimit me shkrim dhe intervistës së aplikuesve për pozitën e shpallur për plotësimin e vendit të punës Zyrtar Ekzekutiv i Këshillit Drejtues në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, bëri përzgjedhjen e aplikuesit me më së shumti pikë Rita Mazrekaj , e cili ka 169 pikë në listën definitive.

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla juridike:** Aplikuesi i pakënaqur me vendimin e komisionit për përzgjedhje ka të drejtë të paraqes ankesë me shkrim në afat prej tetë (8) ditësh, nga pranimi i vendimit, te Komisioni i Ankesave.

Kryetare e Komisionit

LL.M Tirana Baftiu-Hasani

B. Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, Zyra e BNJ dhe Zyra e Komunikimit, Kandidatëve, Arkivi i Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 1405 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 17.06.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Në mbështetje të nenit 38 paragrafit 3 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, dhe nenit 17 paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nxjerrë këtë:

**VENDIM**

I. E punësuara z. Alberina Brahimaj e cili aktualisht është Zyrtare për çështje studentore në njësinë akademike/ Fakultetin Juridik në UHZ-së, sistemohet në pozitën Zyrtar për çështje studentore në njësinë Akademike / Fakultetin e Agrobiznesit në nivel të njëjtë të pagës dhe kategorisë funksionale duke filluar nga dt. 20.06.2022.

II. E lartëcekura është e obliguar që t'i përmbushë të gjitha të drejtat dhe detyrimet si Zyrtare për çështje studentore sipas përshkrimit të vendit të punës të parapara me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në UHZ-së.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Për shkak të nevojave të paraqitura në Fakultetin e Agrobiznesit për një Zyrtar për çështje studentore, në mënyrë që procesi i punës në këtë njësi akademike të bëhet në mënyrë permanente dhe pa ngecje, bëhet sistemimi i z. Alberina Brahimaj e cili aktualisht është Zyrtare për çështje studentore në njësinë akademike/ Fakultetin Juridik sipas kontratës së punës nr. 1977 dt.30.07.2021, në pozitën Zyrtare për çështje studentore në Njësinë Akademike - Fakultetin e Agrobiznesit.

Nga sa u tha më lartë u vendos, si në dispozitiv të këtij vendimi.

**LL.M. Tirana Baftiu Hasani – U.d. Sekretare e Përgjithshme/ UHZ-së**

B. Hasani

**Data 17/06/2022**

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurës, U.d. Sekretares së Përgjithshëm, Dekanit të Fakultetit Juridik, Dekanit të Fakultetit të Agrobiznesit, Sekretares së njësisë së Fakulteti Juridik, Sekretarit të njësisë së Fakultetit të Agrobiznesit , Departamentit për Buxhet dhe Financa, Zyres së Burimeve Njerëzore, Kryesuesit për Teknologji të Informacionit, Udhëheqësit të Sektorit të Arkivit.

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 1410 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 17.06.2022 Pejë / Peć

17.06.2022

Duke u bazuar në neni 41 paragrafi 1.2, 1.4, neni 183 të Statutin Nr. 04 -V - 662 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, nenit 68 paragrafi 4 dhe 7 të Ligjit nr. 06/L - 114 për zyrtarët publikë dhe nenin 7 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nxjerr këtë:

## VENDIM

**I.** Themelohet Komisioni Përzgjedhës ad-hoc për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën Asistente e Dekanit , në Njësinë Akademike /Fakulteti Biznesit, në përbërje si në vijim:

1. Znj. Liridon Cukaj - Sekretar në Fakultetin e Biznesit /- Kryetare;
2. Znj. Valbona Luta - Drejtor për çështje studentore / Rektorat - anëtare;
3. Z. Osman Sejfijaj – Drejtor i ASHP /Rektorat - anëtare;
4. Z. Rialda Muharemi – Zyrtare për çështje studentore / F.Biznesit - anëtar;
5. Z. Agron Halitaj – Zyrtar për buxhet dhe financa/ F. Biznesit – anëtare.

**II.** Komisioni Përzgjedhës është përgjegjës për menaxhimin e vlerësimit, përgatitjen e listës së shkurtër, për caktimin e orarit të përzgjedhjes, përpilimin e testit, mbajtjen e testimeve sipas procedurës me shkrim, mbajtjen e Intervistës, vlerësimin e rezultateve dhe propozimin për listën përfundimtare përzgjedhëse për kandidatin e suksesshmen.

**III.** Mandati i Komisionit përzgjedhës përfundon me nxjerrjen e vendimit përfundimtar për përzgjedhjen e kandidatit .

**IV**. Vendimi hyn në fuqi ditë e nënshkrimit.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

B. Hasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" SEKRETARI I PËRGJITHSHËM PEJË

**Vendimi i dorëzohet:** Anëtarëve të Komisionit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Zyres së Personelit, Kyesuesit të TI dhe Arkivit të Universitetit.

Adresa: Rr. "UÇK-së" 30000 Pejë
www.unhz.eu ; E-mail: info@unhz.eu ; Tel. : +381/39/423 270

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 1526 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 29.06.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**Datë: 29.06.2022**

Në bazë të nenit 41, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, nenit 10,11, 12, të Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasjen në Dokumentet Publike, si dhe kërkesës së parashtruar nga Mediumi Demokracia.com, me nr. protokoli 508 dt. 23 Qershor 2022 , nxjerr këtë:

**VENDIM**

I. Për lejimin e qasjes së mediumit Demokracia.com në dokumentin e kërkuar: Procesverbali i mbledhjes datë 04.10.2021, të Këshillit Drejtues të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, sipas kërkesës me nr protokoli 508 dt. 23 Qershor 2022.

II. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Mediumi Demokracia.com ka parashtruar kërkesë me shkrim me datë 23.06.2022, me nr.prot: 508, përmes postës elektronike të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, për qasje në procesverbalin e mbledhjes së Këshjllit Drejtues të datës 04.10.2021. Sipas obligimeve kushtetuese, ligjore dhe statutare Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, respektivisht personi i autorizuar në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, pas shqyrtimit të bazës juridike ka lejuar dhe do të përgjigjet me dërgimin e kopjes së dokumentit të kërkuar.

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

U.D. Sekretare e Përgjithshme

LL.M Tirana Baftiu-Hasani

TBHasani

**Vendimi t'i dërgohet**: Mediumit Demokracia .com, Këshillit Drejtues, Rektorit, Zyrës së Sekretares së Përgjithshme, Zyrës së Komunikimit, Zyrës së ADSH-së, Arkivi i Universitetit.

Në

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 1539 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 30.06.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

**Vendimi Nr. 06/2022/ZKA / 30.06.2022**

Në mbështetje të nenit 41 paragrafit 1 nën paragrafi 1.2. dhe 1.4. të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, nenit 53 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nxjerrë këtë:

## V E N D I M

**Për ndryshim, plotësimin e vendimit Nr.848/22**

I. **Ndryshohet dhe plotësohet** neni I pika 3 e vendimi me nr. 848 dt. 19.04.2022 të Komisionit për shqyrtimin e ankesave për nëpunësit e shërbimit publik në kuadër të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë .

II. Znj. Mandeta Hadërgjonaj / Drejtoresh për BNJ dhe BGJ –anëtare, zëvendësohet me anëtarin e ri Osman Sejfijaj /Drejtor i ASHP.

III. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

## A R S Y E T I M

Sipas nenit I pika 3 të vendimit nr. 848 dt. 19.04.2022 për themelimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për nëpunësit e shërbimit publik në kuadër të Universitetit " Haxhi Zeka" Pejë, znj. Mandeta Hadërgjonaj / Drejtoresh për BNJ dhe BGJ, është caktuar anëtare e komisionit, po për shkak se e lartpërmendura sipas kërkesës me nr. 1183 dt.25.05.2022, lidhur me njoftimin për dorëheqjen nga dt. 01.06.2022, nga pozita e Drejtorit për BNJ dhe BGJ, si dhe për shkak të mos ngecjes së procedurave të mëtutjeshme shqyrtimit të ankesave nga Komisioni i ankesave për nëpunësit e shërbimit publik ndryshohet dhe plotësohet neni I pika 3 e vendimi me nr. 848 dt. 19.04.2022, me anëtarin e ri Osman Sejfijaj /Drejtor i ASHP, i cili sipas vendimit nr. 1293 dt.07.06.2022, autorizohet që përveç detyrave të parapara si Drejtor i ASHP, nga dt. 08.06.2022 si punë shtesë t'i kryej edhe detyrat e Drejtorit për BNJ dhe BGJ.

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

*[signature]*

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi t'i dërgohet:** U.d. Sekretares së Përgjithshme, Osman Sejfijaj – Drejtor i ASHP, Ukë Selimaj- Sekretar i njësisë Akademike/ F.Agrobiznesit, Armend Alimusaj - zyrtar për paga , Kryesuesit për Teknologji të Informacionit, Arkivit të Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 1540 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 30.06.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Pejë, 30.06. 2021

Në bazë të nenit 41 të Statutit nr.04-v-622 të UHZ-së, si dhe shqyrtimit të kërkesës nr. 1408 dt. 17.06.2022, të z. Përparim Blakaj/ Zyrtar për Çështje Studentore në Fakultetin e Biznesit, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

I. **Refuzohet** kërkesa nr. 1408 dt. 17.06.2022, e z. Përparim Blakaj/ Zyrtar për Çështje Studentore në Fakultetin e Biznesit për pushim pa pagesë për periudhën 1 vjeçare prej dt. 01.07.2022 deri me 30.06.2023.

II. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Pas shqyrtimit të kërkesës nr. 1408 dt. 17.06.2022, të z. Përparim Blakaj/Zyrtar për Çështje Studentore në Fakultetin e Biznesit, për pushim pa pagesë për periudhën 1 vjeçare prej dt. 01.07.2022 deri me 30.06.2023, me arsyetim "të të menduarit të zhvillojë karrierë gjegjësisht studimet master në një Universitet jashtë vendit ", konstatoi se kërkesa e të lartpërmendurit refuzohet. Kjo për shkak se Universiteti "Haxhi Zeka" ka mungesë të theksuar të personalit administrativ nëpër njësi akademike e po ashtu, në kuadër të planit për zhvillimin strategjik në kohën e paraqitjes së kërkesës, administrata dhe personali i saj në UHZ, gjenden në procesin e ristrukturimit dhe riorganizimit e cilat, posaçërisht në këtë fazë, ndërlidhet edhe me nevojën e trajnimeve në sferën e rritjes së kompetencës së tyre profesionale. Andaj, mbi këto baza dhe në përputhje me nenin 40 pika 1, Ligji nr. 03/L-212 i Punës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të inicoj kontest pune në Gjykatën Kompetente, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

U.d. Sekretare e Përgjithshme e Universitetit

LL.M. Tirana Baftiu - Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Drejtorit të ASHP, Drejtorit për buxhet dhe financa, Zyrtarit për paga, Arkivit të Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë.

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 1558 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 2
Data / Datum / Date: 05 / 07 / 2022 Pejë / Peć

**u. d Sekretari i Përgjithshëm** Ref. Nr. Pejë, 05.07.2022

Në bazë të nenit 38, 41, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, vendimit të Këshillit Drejtues ref. nr. 1305/22, të dt. 07.06.2022, vendimit të Senatit ref. nr. 287/22, të dt. 18.02.2022, u. d Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit, më dt. 05.07.2022, mori këtë:

**VENDIM**

I. Prof. Juljana Imeraj e angazhuar në cilësinë e mësimdhënësit ndërkombëtar në Universitetin Veror UNISUM, të Organizuar nga UHZ, i lejohet kompensimi i udhëtimit në shumën prej 106,69 euro (njëqind e gjashtë euro e gjashtëdhjetë e nëntë cent) ;

II. Kompensimi do të bëhet konfrom vendimit të Këshillit Drejtues ref. nr. 1305/22, të dt. 07.06.2022;

III. Obligohet zyra e financave e UHZ – së, për ekzekutimin e këtij vendimi;

IV. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi t'i dërgohet;

- Prof. Juljana Imeraj
- Prorektorit për Bashkëpunim Ndërkombëtar
- Prorektores Për Buxhet Financa dhe Infrastrukturë
- U. d. Sekretarit të Përgjithshëm
- Zyrës së Financave
- Arkivit të UHZ - së

u. d Sekretare e Përgjithshme:
LLM. Tirana Baftiu Hasani

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 1632 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 15.07.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**Dt. 15.07.2022**

Në mbështetje të nenit 38 paragrafit 3 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, dhe Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nxjerrë këtë:

**VENDIM**

I. Z. Sami Gjuka Koordinator i Shërbimeve të Përgjithshme dhe Njësisë së Transportit, caktohet Zëvendësues i Drejtorit për Shërbimeve të Përgjithshme dhe Transport, në Zyrën për Shërbime të Përgjithshme dhe Transport në kuadër të UHZ-së .

II. I lartëcekuri është i obliguar që t'i përmbushë të gjitha të drejtat dhe detyrimet si zëvendësues i Drejtorit për Shërbimeve të Përgjithshme dhe Transportit, sipas përshkrimit të vendit të punës të parapara me Rregulloren nr.247/20 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në UHZ-së, dhe Rregullore nr. 414/20 për përshkrimin e vendeve të punës në Administratë të UHZ-së

III. I lartëcekuri detyrën do ta ushtrojë nga dt. 18.07.2022 , deri në marrjen e një Vendimi tjetër.

IV. Obligohet Zyra për Buxhet, Financa dhe Infrastruktur që pagesën ta bëjë sipas Uni 31 - kategorisë (D).

V. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**ARSYETIM**

Me qëllim të funksionalizimit të kësaj pozitë Z. Sami Gjuka Koordinator i Shërbimeve të Përgjithshme dhe Njësisë së Transportit, caktohet Zëvendësues i Drejtorit për Shërbimeve të Përgjithshme dhe Transport, në Zyrën për Shërbime të Përgjithshme dhe Transport në kuadër të UHZ-së .

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**LL.M. Tirana Baftiu Hasani – U.d. Sekretare e Përgjithshme/ UHZ-së**

**Nënshkrimi** B.Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurit, U.d. Sekretares së Përgjithshëm, Prorektores për Buxhet, Financa dhe Infrastruktur, Departamentit për Buxhet, Financa dhe Infrastruktur, Zyrtarit për paga, Zyres së Burimeve Njerëzore, Kryesuesit për teknologji të informacionit, Udhëheqësit të Sektorit të Arkivit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 1633 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 15.07.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**Dt. 15.07.2022**

Në mbështetje të nenit 38 paragrafit 3 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, nenit 53 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nxjerrë këtë:

## VENDIM

I. Shfuqizohet Vendimi nr. 1293 i dt. 07.06.2022 , për caktimin e personit përgjegjës për punë shtesë për pozitën e Drejtorit për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore.

II. Znj. Afrodita Gashi Zyrtare për Financa në njësinë akademike / Fakulteti Juridik , caktohet Zëvendësues i Drejtorit për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore, në kuadër të UHZ-së.

III. E lartëcekura është e obliguar që t'i përmbushë të gjitha të drejtat dhe detyrimet si zëvendësues i Drejtorit për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore, sipas përshkrimit të vendit të punës të parapara me Rregulloren nr.247/20 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në UHZ-së, dhe Rregullore nr. 414/20 për përshkrimin e vendeve të punës në Administratë të UHZ-së.

IV. E lartëcekura detyrën do ta ushtrojë nga dt. 18.07.2022 , deri në marrjen e një Vendimi tjetër.

V. Obligohet Zyra për Buxhet, Financa dhe Infrastruktur, që pagesën ta bëjë sipas Uni 31 - kategorisë (D).

VI. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

## ARSYETIM

Sipas kërkesës nr.1260 dt. 01.06.2022 znj. Mandeta Hadërgjonaj nga dt. 01.07.2022 ka dhënë dorëheqje nga pozita e Drejtorit për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, si dhe për shkak se detyrat e këtij pozicioni nuk janë të mbuluara aktualisht nga asnjë zyrtar, sepse edhe zyrtarja e personelit Diliko Kaci Shala sipas vendimit nr.3221/21, për të drejtën e pushimit të lehonisë nga dt. 25.11.2021 deri me dt. 25.11.2022, është në pushim të lehonisë, andaj me qëllim të funksionalizimit të kësaj pozite Znj. Afrodita Gashi Zyrtare për Financa në njësinë akademike / Fakulteti Juridik, caktohet Zëvendësues i Drejtorit për Burime Njerëzore dhe Barazi Gjinore në kuadër të UHZ-së.

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**LL.M. Tirana Baftiu Hasani – U.d. Sekretare e Përgjithshme/ UHZ-së**

**Nënshkrimi** BHasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurës, U.d. Sekretares së Përgjithshëm, Prorektores për Buxhet, Financa dhe Infrastruktur, Dekanit të F.Juridik, Sekretares së Njësisë Akademike- F.Juridik Departamentit për Buxhet, Financa dhe Infrastruktur, Zyrtarit për paga, Zyres së Burimeve Njerëzore, Kryesuesit për teknologji të informacionit, Udhëheqësit të Sektorit të Arkivit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 1644 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 18.07.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Dt.18.07.2022

Në mbështetje të nenit 38 paragrafit 3 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, nenit 53 paragrafi 1 dhe 3, të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, dhe kërkesës sipas emailit zyrtar dt. 18.07.2022 të znj. Myhybije Zallqi Zharra për dorëheqje nga pozita U.d. Drejtor për marrëdhënie me publikun në Administratën Qendrore nxjerrë këtë:

**VENDIM**

I. Aprovohet kërkesa sipas emailit zyrtar dt. 18.07.2022 e znj. Myhybije Zallqi Zharra për dorëheqje nga pozita U.d. Drejtor për marrëdhënie me publikun në Administratën Qendrore.

II. Shfuqizohet Vendimi nr. 3503 i dt. 31.12.2021, për sistemimin në pozitën e U.d. Drejtor për marrëdhënie me publikun në Administratën Qendrore në kuadër të Rektoratit.

III. E lartpërmendura Rikthehet në pozitën e mëparshme si Zyrtare për çështje studentore në njësinë akademike në Fakultetin e Agrobiznesit

IV. E lartëcekura është e obliguar që t'i përmbushë të gjitha të drejtat dhe detyrimet si Zyrtare për çështje studentore në njësinë akademike në Fakultetin e Agrobiznesit, sipas përshkrimit të vendit të punës të parapara me Rregulloren nr.247/20 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në UHZ-së, dhe Rregullore nr. 414/20 për përshkrimin e vendeve të punës në Administratë të UHZ-së.

V. E lartëcekura detyrën do ta ushtrojë nga dt. 19.07.2022 .

VI. Obligohet Zyra për Buxhet, Financa dhe Infrastruktur, që pagesën ta bëjë sipas Uni 28 - kategorisë (A).

VII. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**ARSYETIM**

Duke u bazuar në kërkesën sipas emailit zyrtar dt. 18.07.2022, të znj. Myhybije Zallqi Zharra për dorëheqje nga pozita U.d. Drejtor për marrëdhënie me publikun në Administratën Qendrore, për shkak të rrethanave ekzistuese, e larpërmendura rikthehet në pozitën e mëparshme si Zyrtare për çështje studentore në njësinë akademike në Fakultetin e Agrobiznesit, ndërsa Zyra për Buxhet, Financa dhe Infrastruktur, obligohet që pagesën ta bëjë sipas Uni 28 - kategorisë (A).

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**LL.M. Tirana Baftiu Hasani – U.d. Sekretare e Përgjithshme/ UHZ-së**

**Nënshkrimi** B Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurës, U.d. Sekretares së Përgjithshëm, Prorektores për Buxhet, Financa dhe Infrastruktur, Dekanit të F.Agrobiznesit, Sekretarit të Njësisë Akademike- F.Agrobiznesit, Departamentit për Buxhet, Financa dhe Infrastruktur, Zyrtarit për paga, Zyres së Burimeve Njerëzore, Kryesuesit për teknologji të informacionit, Udhëheqësit të Sektorit të Arkivit.

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 1659 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date: 19.07.2022 Pejë / Peć

---

Në mbështetje të nenit 38 paragrafit 3 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, dhe nenit 17 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nxjerrë këtë:

**VENDIM**

I. Nëpunësja Rialda Muharremi e cili aktualisht është Asistente e Dekanit në njësinë akademike/ Fakultetin e Biznesit në UHZ-së, sistemohet në pozitën Zyrtar për çështje studentore (gjuhën boshnjake) në njësinë Akademike / Fakultetin e Biznesit.

II. E lartëcekura është e obliguar që t'i përmbushë të gjitha të drejtat dhe detyrimet si Zyrtare për çështje studentore sipas përshkrimit të vendit të punës të parapara me Rregulloren nr.414 /20 për përshkrimin e vendeve të punës në administratën e UHZ-së.

III. E lartëcekura detyrë do ta ushtrojë nga dt. 20.07.2022.

IV. Obligohet Zyra për Buxhet, Financa dhe Infrastruktur, që pagesën ta bëjë sipas UNI 28 – kategorisë (A).

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Duke pasur parasysh se në Fakultetin e Biznesit ka programe të studimit në Gjuhën Boshnjake dhe në mënyrë që procesi i punës në këtë njësi akademike të bëhet në mënyrë permanente dhe pa ngecje, është i domosdoshëm sistemimi i nëpunëses znj. Rialda Muharremi në pozitën e lartëcekur.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**LL.M. Tirana Baftiu Hasani – U.d. Sekretare e Përgjithshme/ UHZ-së**

**Nënshkrimi** TBHasani

**Data 19/07/2022**

---

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurës, U.d. Sekretares së Përgjithshëm, Dekanit të Fakultetit të Biznesit, Sekretarit të njësisë së Fakulteti të Biznesit, Departamentit për Buxhet dhe Financa, Menaxheres së Burimeve Njerëzore, Kryesuesit për teknologji të informacionit, Udhëheqësit të Sektorit të Arkivit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 1655 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 20.07.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Në mbështetje të nenit 38 paragrafit 3 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, nenit 69 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, si dhe njoftimit për dorëheqje përmes emailit zyrtar të. dt. 11 korrik 2022 , nxjerrë këtë:

## VENDIM

I. Aprovohet kërkesa për dorëheqje e nëpunëses Znj. Kaltrina Kelmendi nga pozita Zyrtare e Lartë për Komunikim me Publikun në Universitetin " Haxhi Zeka" në Pejën.

II. Obligohet zyrtari për paga që të vazhdoj me procedurat e mëtutjeshme.

III. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

## ARSYETIM

Me me anë të emailit zyrtar datën 11 korrik 2022, Zyrtarja e Lartë për Komunikim me Publikun në Universitetin "Haxhi Zeka " në Pejë, znj. Kaltrina Kelmendi ka bërë njoftim për dorëheqje respektivisht ndërprerje të kontratës së punës në mënyrë të njëanshme nga pozita e lartëcekur.

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**LL.M. Tirana Baftiu Hasani – U.d. Sekretare e Përgjithshme/ UHZ-së**

**Nënshkrimi** ________________ B. Hasani

**Data 19/07/2022**

**Vendimi i Dërgohet:** Të lartpërmendurës , U.d. Sekretares së Përgjithshme, Departamentit për Buxhet dhe Financa, Zyres së Personelit dhe Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 1695 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 22.07.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Dt. 22.07.2022

Në mbështetje të nenit 41 paragrafit 1 nën paragrafi 1.2. dhe 1.4. të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, nenit 53 paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nxjerrë këtë:

**VENDIM**

I. **NDRYSHOHET pika 4** e vendimi me nr. 936 dt. 28.04.2022 për themelimin e komisionit disiplinor për nëpunësit e shërbimit publik në kuadër të UHZ-së.

II. Anëtarja e komisionit znj. Diliko Kaçi , zëvendësohet me anëtaren Afrodita Gashi.

III. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**ARSYETIM**

Për shkak se nëpunësja znj. Diliko Kaçi është në pushim të lehonisë, bëhet zëvendësimi me anëtaren Afrodita Gashi, sipas dispozitave të parapara me nenin 72 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1. të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, si dhe duke ju referuar nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit të lartëcekur ku parashihet se një akt administrativ mund të ndryshon apo plotëson aktin e parë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

B.Hasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurave , U.d. Sekretares së Përgjithshme, zv. Drejtoreshës së BNJ dhe BGJ, Anëtarëve të Komisionit Disiplinor në kuadër të UHZ, Kryesuesit për Teknologji të Informacionit, Arkivit të Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 1730 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Datum / Date: 27.07.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

27.07.2022

Duke u bazuar në neni 41 paragrafi 1.2, 1.4, neni 183 të Statutin Nr. 04 -V - 662 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, nenit 68 paragrafi 4 dhe 7 të Ligjit nr. 06/L - 114 për zyrtarët publikë dhe nenin 7 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nxjerr këtë:

## VENDIM

**I.** Themelohet Komisioni Përzgjedhës ad-hoc për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën Asistente e Dekanit , në Njësinë Akademike /Fakulteti Biznesit, në përbërje si në vijim:

1. Znj. Fatmire Thaçi- Sekretar e Njësisë në Fakultetin Juridik /- Kryetare;
2. Znj. Valbona Luta - Drejtor për çështje studentore / Rektorat - anëtare;
3. Znj. Afrodita Gashi – zv.Drejtor i BNJ dhe BGJ /Rektorat - anëtare;
4. Z. Agron Halitaj – Zyrtar për buxhet dhe financa/ F. Biznesit – anëtare.
5. Z. Kushtrim Agaj – Asistent i Dekanit / F. Arteve - anëtar;

**II.** Komisioni Përzgjedhës është përgjegjës për menaxhimin e vlerësimit, përgatitjen e listës së shkurtër, për caktimin e orarit të përzgjedhjes, përpilimin e testit, mbajtjen e testimeve sipas procedurës me shkrim, mbajtjen e Intervistës, vlerësimin e rezultateve dhe propozimin për listën përfundimtare përzgjedhëse për kandidatin e suksesshmen.

**III.** Mandati i Komisionit përzgjedhës përfundon me nxjerrjen e vendimit përfundimtar për përzgjedhjen e kandidatit .

**IV.** Vendimi hyn në fuqi ditë e nënshkrimit.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi i dorëzohet:** Anëtarëve të Komisionit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Zyres së Personelit, Kyesuesit të TI dhe Arkivit të Universitetit.

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

22.08.2022

Duke u bazuar në neni 41 paragrafi 1.2, 1.4, neni 183 të Statutin Nr. 04 -V - 662 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, nenit 68 paragrafi 4 dhe 7 të Ligjit nr. 06/L - 114 për zyrtarët publikë dhe nenin 7 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017. për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe nenit 49 pararafi1 nenparagrafi 1.3. te Ligjit nr. 05/L-031 per proceduren e pergjithshme administrative, nxjerr këtë:

**VENDIM**

**I.** Themelohet Komisioni Përzgjedhës ad-hoc për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën Drejtor i Zyrës për Bashkëpunim Ndërkombëtar, në përbërje si në vijim:

1. Z. Veton Jahmurataj - Kryetar;
2. Z. Driton Fetaj - anëtar;
3. Znj. Afrodita Gashi - anëtare;
4. Znj. Shqipe Loshaj - anëtare;
5. Z. Osman Sejfijaj – anëtar.

**II.** Komisioni Përzgjedhës është përgjegjës për menaxhimin e vlerësimit, përgatitjen e listës së shkurtër, për caktimin e orarit të përzgjedhjes, përpilimin e testit, mbajtjen e testimeve sipas procedurës me shkrim, mbajtjen e Intervistës, vlerësimin e rezultateve dhe propozimin për listën përfundimtare përzgjedhëse për kandidatin e suksesshmen.

**III.** Mandati i Komisionit përzgjedhës përfundon me nxjerrjen e vendimit përfundimtar për përzgjedhjen e kandidatit .

**IV.** Vendimi hyn në fuqi ditë e nënshkrimit.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi i dorëzohet:** Anëtarëve të Komisionit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Drejtoreshës së BNJ dhe BGJ Kyesuesit të TI dhe Arkivit të Universitetit.

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 2013 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date: 01 / 09 / 2022 Pejë / Peć

Duke u bazuar në nenin 53 të Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 10 paragrafi 5 të Rregullores QRK Nr. 11/2020 për disiplinën dhe ankesat e zyrtarëve publik, si dhe neni 41 të Statutin Nr. 04 -V - 662 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, nxjerr këtë:

**VENDIM**

I. Shfuqizohet pjesërisht Vendimit nr. 936 i dt. 28.04.2022, lidhur me themelimin e Komisionit disiplinor për nëpunësit e shërbimit publik në kuadër të UHZ- Së, Pejë.

II. Ndryshohet dhe plotësohet pika I me nr. 1 dhe 3 e Vendimit nr. 936 i dt. 28.04.2022, lidhur me themelimin e Komisionit disiplinor për nëpunësit e shërbimit publik në kuadër të UHZ- Së, Pejë.

III. Zëvendësohet Kryesuesi i komisionit z Petrit Bajraktari, me kryesuesin e ri të këtij komisioni. Kryesues i ri i komisioni emërohet znj. Fatmire Thaçi.

IV. Zëvendësohet anëtari i komisionit z. Agron Halitaj , me anëtarin e ri të komisioni. Anëtar i ri i këtij komisioni emërohet z. Osman Sejfijaj.

V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Për shkak të mos ngecjes së procedurave të mëtutjeshme të Komisionit disiplinor për nëpunësit e shërbimit publik në kuadër të UHZ- Së, Pejë, si dhe duke u bazuar në kërkesën e dt. 31.08.2022 të z. Petrit Bajraktari – Kryesues i Komisionit disiplinor për nëpunësit e shërbimit publik në kuadër të UHZ- së, Pejë, i cili me datën 29/08/2022 ka vërejtur se është në konfliktë të interesit me shkelësin e dyshuar, e njëjta procedurë është edhe me anëtarin e komisionit z. Agron Halitaj për shkak se shkelësi i dyshuar është mbikëqyrës i drejtpërdrejt i z. Agron Halitaj, bëhet zëvendësimi i dy anëtarëve të komisionit sipas nenit 10 paragrafi 5 të Rregullores QRK Nr. 11/2020 për disiplinën dhe ankesat e zyrtarëve publik.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

Hasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi i dorëzohet:** Të lartpërmendurve, Anëtarëve të Komisionit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Dekanit të F. Biznesit, Sekretarit të Njësisë Akademike të F. Biznesit, Kyesuesit të TI dhe Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 2022 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 02.09.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Pejë, 01.09. 2022

Në bazë të nenit 67 paragrafi 1 nën paragrafi 1.9. dhe neni 72 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 41 të Statutit nr.04-v-622 të UHZ-së, nxjerr këtë:

**VENDIM**

I. I ndërprehet kontrata e punës me nr. protokolli 1981 dt.30.07.2021 z. Përparim Blakaj në pozitën e Zyrtarit për çështje studentore në Universitetin "Haxhi Zeka" Pejë, për mos paraqitje në punë prej dt. 01.07.2022.

II. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Sipas vendimit nr. 1540 dt. 30.06.2022 për refuzimin e pushimit pa pagesë për periudhën 1 vjeçare prej dt. 01.07.2022 deri me 30.06.2023, njoftimit / sqarimit dt.30.08.2022 të z. Liridon Cukaj , Sekretar i Njësisë Akademike në Fakultetin e Biznesit përkatësisht Menaxher i Drejtpërdrejt i z. Përparim Blakaj zyrtar për çështje studentore, për mos paraqitje në punë të të lartëpërmendurit prej dt. 01.07.2022 ( 2 muaj ) e tutje , përkatësisht për mos përmbushje të detyrimeve të cilat rrjedhin nga kontrata e punës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Komisionin e Ankesave për nëpunësit e shërbimit publik në kuadër të UHZ-së, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga njoftimi i vendimit.

U.d. Sekretare e Përgjithshme e Universitetit

LL.M. Tirana Baftiu – Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Dekanit të F. Biznesit , Sekretarit të njësisë akademike të F.Biznesit, Drejtorit për buxhet dhe financa, Zyrtarit për paga, zv. Drejtor për burime njerëzore dhe barazi gjinore, Zyres Arkivit të Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 2085 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 14 09 2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Pejë, 14.09.2022

Në bazë të nenit 41 të Statut të Universitetit "Haxhi Zeka " në Pejë, si dhe me qëllim të caktimit të personit përgjegjës për punë shtesë për pozitën e Sekretarit të njësisë akademike në Fakultetin e MTHM, nxjerr këtë:

**VENDIM**

I. **Autorizohet: z. Liridon Cukaj** – Sekretar i njësisë akademike në Fakultetin e Biznesit që përveç detyrave të parapara si Sekretar i njësisë akademike në Fakultetin e Biznesit, nga dt. 14.09.2022, si punë shtesë t'i kryej edhe detyrat e Sekretarit të njësisë akademike në Fakultetin e MTHM.

II. Vendimi është i vlefshëm deri në marrjen e një vendim tjetër.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Znj. Besa Baloku me pozitë Sekretare e njësisë akademike në Fakultetin e MTHM, sipas vendimit nr.2034/22, është në pushim të lehonisë, andaj për shkak se detyrat e këtij pozicioni nuk janë të mbuluara aktualisht nga asnjë zyrtar, Sekretari i njësisë akademike në Fakultetin e Biznesit **z. Liridon Cukaj** autorizohet që përveç detyrave të parapara si Sekretar i njësisë akademike në Fakultetin e Biznesit, nga dt. 14.09.2022, si punë shtesë t'i kryej edhe detyrat e Sekretarit të njësisë akademike në Fakultetin e MTHM deri në marrjen e një vendimi tjetër .

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

U.d. Sekretare e Përgjithshme

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurit, Dekanit të F. Biznesit, Dekanit të F.MTHM, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Menaxheres së Burimeve Njerëzore, Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË — UNIVERSITETI / UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 2106 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date: 14.09.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Pejë, 14.09.2022

Në bazë të nenit 41 të Statut të Universitetit "Haxhi Zeka " në Pejë, nenit 53 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregulloren nr. 414/20 për përshkrimin e vendeve të punës në administratën e UHZ-së, si dhe me qëllim të caktimit të personit përgjegjës për punë shtesë për pozitën e Zyrtarit për Master dhe Doktoratë në Fakultetin e Biznesit, nxjerr këtë:

## VENDIM

I. Shfuqizohet vendimi nr. 389 dt.01.03.2022 .

II. Autorizohet: znj. Mimoza Nurboja – Zyrtare për Master dhe Doktoratë në njësinë akademike në Fakultetin e MTHM, që përveç detyrave të parapara si Zyrtare për Master dhe Doktoratë në FMTHM, nga dt. 15.09.2022, si punë shtesë t'i kryej edhe detyrat e Zyrtarit për Master dhe Doktoratë në Fakultetin e Biznesit.

III. Vendimi është i vlefshëm deri në marrjen e një vendimi tjetër.

IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Për shkak se Zyrtarit për Master dhe Doktoratë në Fakultetin e Biznesit, z. Përparim Blakaj sipas vendimit nr. 2022/22 dt. 02.09.2022, i është shkëputur kontrata e punës, kurse detyrat e këtij pozicioni nuk janë të mbuluara aktualisht nga asnjë zyrtar ndërsa kjo pozitë është më se e nevojshme në mënyrë që procesi i punës të bëhet pa ngecje, **znj. Mimoza Nurboja** autorizohet që përveç detyrave të parapara si Zyrtare për Master dhe Doktoratë në njësinë akademike në Fakultetin e MTHM, nga dt. 15.09.2022, si punë shtesë t'i kryej edhe detyrat e Zyrtarit për Master dhe Doktoratë në Fakultetin e Biznesit, deri në marrjen e një vendimi tjetër .

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

U.d. Sekretare e Përgjithshme

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

B.Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurës, Dekanit të F.MTHM, Dekanit të F. Biznesit U.d. Sekretares së Përgjithshme, Menaxheres së Burimeve Njerëzore, Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 2104 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 14.09.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Pejë, 14.09.2022

Në bazë të nenit 41 të Statut të Universitetit "Haxhi Zeka " në Pejë, Rregulloren nr. 414/20 për përshkrimin e vendeve të punës në administratën e UHZ-së, si dhe me qëllim të caktimit të personit përgjegjës për punë shtesë për pozitën e Zyrtarit për sigurim të cilësisë në Fakultetin e MTHM, nxjerr këtë:

**VENDIM**

I. **Autorizohet: z. Armend Fetahaj** – Zyrtar për financa në njësinë akademike në Fakultetin e MTHM, që përveç detyrave të parapara si Zyrtar për Financa , nga dt. 15.09.2022, si punë shtesë t'i kryej edhe detyrat e Zyrtarit për sigurim të cilësisë në Fakultetin e MTHM.

II. Vendimi është i vlefshëm deri në marrjen e një vendimi tjetër.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Për shkak se detyrat e këtij pozicioni nuk janë të mbuluara aktualisht nga asnjë zyrtar dhe Zyrtari për sigurim të cilësisë është më se i nevojshëm në mënyrë që procesi i punës të bëhet pa ngecje, **z. Armend Fetahaj** autorizohet që përveç detyrave të parapara si Zyrtar për financa , nga dt. 15.09.2022, si punë shtesë t'i kryej edhe detyrat e Zyrtarit për sigurim të cilësisë në njësinë akademike në Fakultetin e MTHM, deri në marrjen e një vendimi tjetër .

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

U.d. Sekretare e Përgjithshme

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

B. Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurit, Dekanit të F.MTHM, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Menaxheres së Burimeve Njerëzore, Arkivit të Universitetit.

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 2107 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Datë / Datum / Date: 14.09.2022 Pejë / Peć

Dt. 14.09.2022

Duke u bazuar në neni 41 paragrafi 1.2, 1.4, neni 183 të Statutin Nr. 04 -V - 662 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, nenit 74 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1. të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 53 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenit 18 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, nxjerr këtë:

**VENDIM**

**I.** Shfuqizohet tërësisht vendimi nr.1539 dt.30.06.2022 për ndryshim, plotësimin e vendimit nr. 848/22.

**II.** Ndryshohet vendimi nr. 848 dt. 19.04.2022 për themelimin e Komisioni për shqyrtimin e Ankesave për nëpunësit e shërbimit publik në kuadër të Universitetit " Haxhi Zeka " Pejë.

**III.** Komisioni për shqyrtimin e Ankesave për nëpunësit e shërbimit publik në kuadër të Universitetit " Haxhi Zeka " Pejë, është në përbërje, si në vijim:

1. z. Ukë Selimaj - Kryesues;
2. Z. Armend Alimusaj - anëtar;
3. Znj. Diliko Kaçi – anëtare.

**II.** Komisioni emërohet për një mandat prej tre (3) vitesh.

**III.** Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit për shqyrtimin e ankesave nuk mund të jenë kryesues dhe anëtarë të komisionit disiplinor.

**IV.** Komisioni Disiplinor është përgjegjës për zhvillimin e procedurave disiplinore dhe masat që shqiptohen sipas Rregullores (QRK) nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

**V.** Të emëruarit janë përgjegjës që të ushtrojnë detyrat në pajtim me Ligjin nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, Rregulloren (QRK) nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe legjislacionin në fuqi.

**VI.** Vendimi hyn në fuqi ditë e nënshkrimi.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

Hasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi i dorëzohet:** Anëtarëve të Komisionit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Drejtoreshës së BNJ dhe BGJ, Kryesuesit të TI dhe Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 2134 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 16.09.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**Dt. 15.07.2022**

Në mbështetje të nenit 38 paragrafit 3 dhe nenit 41 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, Vendimit të Qeverisë nr.02/39 dt. 08.10.2008, Rregulloren nr.3071 dt.20.11.2018 për unifikimin e të ardhurave të personelit administrativ në universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, kërkesës nr. 2121 dt. 15.09.2022 të znj. Fitore Ajdini- Gjuka, për shtesë në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare, në fushën e Inxhinierisë, nxjerrë këtë:

**VENDIM**

**I.** Aprovohet kërkesa nr. 2121 dt. 15.09.2022 e znj. Fitore Ajdini- Gjuka, për shtesë në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare, në fushën e Inxhinierisë.

**II.** Shtesa në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare, në fushën e Inxhinierisë është në vlerë prej 250 Euro.

**III.** Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**ARSYETIM**

Duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë nr. 02/39të datës 08.10.2008, për miratimin e pozitave dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare, DASHC/MAP, ku në Aneksi I - listën dhe titujt e punonjësve që janë përfitues të masave stimuluese është përfshirë edhe shtesa në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare, në fushën e Inxhinierisë, Rregulloren nr. 3071 dt.20.11.2018 për unifikimin e të ardhurave të personelit administrativ në universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, ku sipas nr. rendor 5 përshkrimi i vendit të punës për Zyrtar i Lartë për Mbikëqyrjen e Ndërtimeve parashihet shtesa sipas vendimit të Qeverisë nr.02/39 dt. 08.10.2008, në shumë prej 250 Euro, shqyrtimit të dokumentacionit plotësues, si dhe kërkesës nr. 2121 dt.15.09.2022 të znj. Fitore Ajdini- Gjuka, për shtesë në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare, në fushën e Inxhinierisë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**LL.M. Tirana Baftiu-Hasani – U.d. Sekretare e Përgjithshme/ UHZ-së**

**Nënshkrimi** BHasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurës, U.d. Sekretares së Përgjithshëm, Prorektores për Buxhet, Financa dhe Infrastruktur, Departamentit për Buxhet, Financa dhe Infrastruktur, Zyrtarit për paga, Zyres së Burimeve Njerëzore, Udhëheqësit të Sektorit të Arkivit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 2231    Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 26.09.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Pejë, 26.09.2022

Në bazë të nenit 41 të Statut të Universitetit "Haxhi Zeka " në Pejë, nenit 7 paragrafi 7.1.1 të Rregullores nr. 414/20 për përshkrimin e vendeve të punës në administratën e UHZ-së, si dhe me qëllim të caktimit të personit përgjegjës për punë shtesë për pozitën Zyrtare e Bibliotekës, nxjerr këtë:

**VENDIM**

I. **Autorizohet: znj. Lumturie Ahmeti** – Zyrtare për çështje studentore në njësinë akademike/ Fakulteti i Agrobiznesit, që përveç detyrave të parapara nga dt. 26.09.2022, si punë shtesë t'i kryej edhe detyrat e Zyrtares për Bibliotekë në Administratën Qendrore të parapara sipas nenit 7 paragrafi 7.1.1 me Rregulloren nr. 414/20 për përshkrimin e vendeve të punës në administratën e UHZ-së.

II. Vendimi është i vlefshëm deri në kthimin e zyrtares për bibliotekë nga pushimi i lehonisë.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Në bazë të Vendimit nr. 2229 dt.26.09.2022 , për të drejtën e pushimit të lehonisë nga dt. 15.09.2022 deri me dt. 15.09.2023, të znj. Afrodita Fetahaj, autorizohet Zyrtarja për çështje studentore në njësinë akademike/ Fakulteti i Agrobiznesit, që nga dt. 26.09.2022, si punë shtesë t'i kryej dhe detyrat e Zyrtares për Bibliotekë në Administratën Qendrore të parapara sipas nenit 7 paragrafi 7.1.1 me Rregulloren nr. 414/20 për përshkrimin e vendeve të punës në administratën e UHZ-së, deri në kthimin e znj. Afrodita Fetahaj - zyrtare për bibliotekë, nga pushimi i lehonisë.

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

U.d. Sekretare e Përgjithshme

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

BHasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurës, Drejtorit të Bibliotekës, , U.d. Sekretares së Përgjithshme, zv.Drejtorit BNJ. dhe BGJ, Sekretarit të F. Agrobiznesit, Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 2263 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 28/09/2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Duke u bazuar në nenin 49 dhe nenin 53 paragrafi 3 të Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 68 paragrafi 7 të Ligjit nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë, neni 41 të Statutit Nr. 04 -V - 662 të Universitetit "Haxhi Zeka" Pejë, nxjerr këtë:

**VENDIM**

**I.** Ndryshohet dhe plotësohet pika I nr. 4 e Vendimit nr. 1730 e dt. 27.07.2022, lidhur me themelimin e Komisioni Përzgjedhës ad-hoc për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën Asistent/e e Dekanit, në njësinë Akademike/ Fakulteti i Biznesit.

**II.** Zëvendësohet anëtari i komisionit Z. Agron Halitaj – Zyrtar për buxhet dhe financa në Fakultetin e Biznesit, me anëtaren e re të këtij komisioni.

**III.** Emërohet Znj. Majlinda Gjuka – Asistent/e e Dekanit / F.MTHM , anëtare e Komisionit Përzgjedhës ad-hoc për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën Asistent/e e Dekanit, në njësinë Akademike/ Fakulteti i Biznesit.

**IV.** Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

BHasani

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi i dorëzohet: znj.** Të lartpërmendurës, Anëtarëve të Komisionit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Kyesuesit të TI dhe Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 2317 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date 04.10.2022 Pejë / Peć

**UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET**
**"HAXHI ZEKA"**

**Pejë, 04.10.2022**

Në bazë të nenit 41 të Statut të Universitetit "Haxhi Zeka " në Pejë, si dhe me qëllim të caktimit të personit përgjegjës për punë shtesë për pozitën e Zyrtar për Sigurim të Cilësisë në njësisë akademike në Fakultetin e MTHM, nxjerr këtë:

**VENDIM**

I. **Autorizohet: z. Agron Halitaj** – Zyrtar për buxhet dhe Financa në njësinë akademike në Fakultetin e Biznesit që përveç detyrave të parapara si Zyrtar për buxhet dhe Financa në njësinë akademike në Fakultetin e Biznesit, nga dt. 05.10.2022, si punë shtesë t'i kryej edhe detyrat e Zyrtarit për Sigurim të Cilësisë në Fakultetin e Biznesit.

II. Vendimi është i vlefshëm deri në marrjen e një vendim tjetër.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Për shkak se detyrat e këtij pozicioni nuk janë të mbuluara aktualisht nga asnjë zyrtar, z. Agron Halitaj me pozitë Zyrtar për buxhet dhe financa në njësinë akademike në Fakultetin e Biznesit, autorizohet që përveç detyrave të parapara si Zyrtar për buxhet dhe financa nga dt. 05.10.2022, si punë shtesë t'i kryej edhe detyrat e zyrtarit për sigurim të cilësisë në njësisë akademike në Fakultetin e Biznesit deri në marrjen e një vendimi tjetër .

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

U.d. Sekretare e Përgjithshme

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurit, Dekanit të F. Biznesit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Zyrës për sigurim të cilësisë dhe vlerësim, Zyres për BNJBGJ, Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 2386 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 11.10.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Pejë, 11.10.2022

Në bazë të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 41 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka " në Pejë, kërkesës nr. 2361 dt. 10.10.2022 për angazhimin e zyrtarëve për sigurim të cilësisë, si dhe me qëllim të caktimit të personit përgjegjës për punë shtesë për pozitën Zyrtar për Sigurim të Cilësisë në njësinë akademike në Fakultetin Juridik, nxjerr këtë:

**VENDIM**

I. **znj. Albana Belegu** asistente e dekanit në njësinë akademike në Fakultetin Juridik angazhohet si staf mbështetës në zyren për sigurim të cilësisë në njësinë akademike në Fakultetin Juridik.

II. Angazhimi në punë shtesë bëhet sipas kërkesës nr. 2361 dt.10.10.2022, me arsyetim të nevojës emergjente dhe mungesës së stafit të rregulltë në zyrën për sigurim të cilësisë në njësinë akademike në Fakultetin Juridik.

III. Angazhimi në punë shtesë do të filloj prej dt. 12.10.2022 deri në rekrutimin e zyrtarit përkatës të përcaktuar me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, por jo më shumë se gjashtë (6) muaj.

IV. Gjatë kryerjes së punës shtesë për orët e punës jashtë orarit, e lartpërmendura do të kompenzohet sipas legjislacionit në fuqi.

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Sipas kërkesës nr. 2361 dt.10.10.2022 për angazhimin e një zyrtari administrativ të rregullt në cilësinë e Zyrtarit për Sigurim të Cilësinë në njësinë akademike në Fakultetin Juridik, për shkak se detyrat e këtij pozicioni nuk janë të mbuluara aktualisht nga asnjë zyrtar ndërsa kjo pozitë është më se e nevojshme në mënyrë që procesi i punës të bëhet pa ngecje, ku Universiteti është në vitin e aplikimit për riakreditim institucional në Agjencinë e Kosovës të Akreditimit dhe mos ushtrimi i detyrave në këtë zyrë do të shkaktojë probleme serioze në realizimin e punëve të kësaj zyre në procesin e riakreditimit institucional, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

U.d. Sekretare e Përgjithshme

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

B. Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurës, Dekanit të F. Juridik, U.d. Sekretares së Përgjithshme, zv. Sekretares së njësisë akademike, Zyrës për sigurim të cilësisë dhe vlerësim, Zyres për BNJBGJ, Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 2387 | Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 11.10.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Pejë, 11.10.2022

Në bazë të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 41 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka " në Pejë, kërkesës nr. 2361 dt. 10.10.2022 për angazhimin e zyrtarëve për sigurim të cilësisë, si dhe me qëllim të caktimit të personit përgjegjës për punë shtesë për pozitën Zyrtar për Sigurim të Cilësisë në njësinë akademike në Fakultetin e Arteve, nxjerr këtë:

**VENDIM**

I. **Z. Kushtrim Agaj** asistent i dekanit në njësinë akademike në Fakultetin e Arteve angazhohet si staf mbështetës në zyren për sigurim të cilësisë në njësinë akademike në Fakultetin e Arteve.

II. Angazhimi në punë shtesë bëhet sipas kërkesës nr. 2361 dt.10.10.2022, me arsyetim të nevojës emergjente dhe mungesës së stafit të rregulltë në zyrën për sigurim të cilësisë në njësinë akademike në Fakultetin e Arteve.

III. Angazhimi në punë shtesë do të filloj prej dt. 12.10.2022 deri në rekrutimin e zyrtarit përkatës të përcaktuar me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, por jo më shumë se gjashtë (6) muaj.

IV. Gjatë kryerjes së punës shtesë për orët e punës jashtë orarit, i lartpërmenduri do të kompenzohet sipas legjislacionit në fuqi.

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Sipas kërkesës nr. 2361 dt.10.10.2022 për angazhimin e një zyrtari administrativ të rregullt në cilësinë e Zyrtarit për Sigurim të Cilësinë në njësinë akademike në Fakultetin e Arteve, për shkak se detyrat e këtij pozicioni nuk janë të mbuluara aktualisht nga asnjë zyrtar ndërsa kjo pozitë është më se e nevojshme në mënyrë që procesi i punës të bëhet pa ngecje, ku Universiteti është në vitin e aplikimit për riakreditim institucional në Agjencinë e Kosovës të Akreditimit dhe mos ushtrimi i detyrave në këtë zyrë do të shkaktojë probleme serioze në realizimin e punëve të kësaj zyre në procesin e riakreditimit institucional, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

U.d. Sekretare e Përgjithshme

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

B.Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurit, Dekanit të F. Arteve, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Sekretares së njësisë akademike, Zyrës për sigurim të cilësisë dhe vlerësim, Zyres për BNJBGJ, Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 2418 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 12.10.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**Dt. 12.10.2022**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 38 paragrafit 3 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, si dhe kërkesës nr. 2378 dt. 11.10.2022, nxjerrë këtë:

## VENDIM

**I.** z.Armend Alimusaj Zyrtar për Paga në Zyren për Buxhet dhe Financa në kuadër të UHZ, caktohet Zëvendësues i Drejtorit për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme, në kuadër të UHZ-së.

**II.** I lartëcekurl është i obliguar që t'i përmbushë të gjitha të drejtat dhe detyrimet si zëvendësues i Drejtorit për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme, sipas përshkrimit të vendit të punës të parapara me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në UHZ-së, dhe Rregulloren për përshkrimin e vendeve të punës në Administratë të UHZ-së.

**III.** I lartëcekuri detyrën do ta ushtrojë nga dt.13.10.2022 , deri në marrjen e një Vendimi tjetër.

**IV.** Obligohet Zyra për Buxhet, Financa dhe Infrastruktur, që pagesën ta bëjë sipas Uni 31 - kategorisë (D).

**V.** Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

## ARSYETIM

Duke u bazuar në kërkesën nr. 2378 dt. 11.10.2022 të z. Osman Sejfijaj – Drejtor për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme për dorëheqje nga pozita aktuale e Drejtorit për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme, si dhe për shkak se detyrat e këtij pozicioni nuk janë të mbuluara aktualisht nga asnjë zyrtar, ndërsa funksionalizimi i kësaj pozite është më se i nevojshëm që procesi i punës të bëhet pa ngecje, caktohet z. Armend Alimusaj Zyrtar për Paga në Zyren për Buxhet dhe Financa, Zëvendësues i Drejtor për Administratë dhe Shërbime të Përgjithshme në kuadër të UHZ-së.

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**LL.M. Tirana Baftiu Hasani – U.d. Sekretare e Përgjithshme/ UHZ-së**

**Nënshkrimi** B Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurit, U.d. Sekretares së Përgjithshëm, Prorektores për Buxhet, Financa dhe Infrastruktur, Drejtorit për Buxhet, Financa dhe Infrastruktur, Zyres së Burimeve Njerëzore, Kryesuesit për teknologji të informacionit, Udhëheqësit të Sektorit të Arkivit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 2469 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 17.10.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**Dt. 17.10.2022**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, Ligji nr. 06/L- 114 për Zyrtar Publike, nenit 38 paragrafit 3 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, si dhe kërkesës dt. 18. 07.2022, nxjerrë këtë:

## VENDIM

I. z. Butrint Xhemajli me pozitë Administrator i Rrjetit të Komunikimeve në Zyren e teknologjisë së informacionit në UHZ, caktohet Zëvendësues i Drejtorit për Marrëdhënie me Publikun, në kuadër të UHZ-së.

II. I lartëcekuri është i obliguar që t'i përmbushë të gjitha të drejtat dhe detyrimet si zëvendësues i Drejtorit për Marrëdhënie me Publikun sipas përshkrimit të vendit të punës të parapara me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në UHZ-së, dhe Rregulloren për përshkrimin e vendeve të punës në Administratë të UHZ-së.

III. I lartëcekuri detyrën do ta ushtrojë nga dt.18.10.2022 , deri në marrjen e një Vendimi tjetër.

IV. Obligohet Zyra për Buxhet, Financa dhe Infrastruktur, që pagesën ta bëjë sipas Uni 31 - kategorisë (D).

V. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

## ARSYETIM

Duke u bazuar në kërkesën dt. 18.07.2022 të znj. Myhybije Zallqi Zhara për dorëheqje nga pozita e U.d. Drejtorit për Marrëdhënie me Publikun, si dhe për shkak se pozita aktuale e këtij pozicioni nuk është e mbuluar nga dt. 18.07.2022 e tutje nga asnjë zyrtar, ndërsa funksionalizimi i kësaj pozite është më se i nevojshëm që procesi i punës të bëhet pa ngecje, caktohet z. Butrint Xhemajli Zëvendësues i Drejtorit për Marrëdhënie me Publikun, në kuadër të UHZ-së, deri në marrjen e një Vendimi tjetër.

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**LL.M. Tirana Baftiu Hasani – U.d. Sekretare e Përgjithshme/ UHZ-së**

**Nënshkrimi** BHasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurit, Rektorit, Asistentes së Rektorit, U.d. Sekretares së Përgjithshëm, Prorektores për Buxhet, Financa dhe Infrastruktur, Drejtorit për Buxhet, Financa dhe Infrastruktur, Zyres së Burimeve Njerëzore, Kryesuesit për teknologji të informacionit, Udhëheqësit të Sektorit të Arkivit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 2477 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 17.10.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

**Dt. 17.10.2022**

Në mbështetje të nenit 41 paragrafit 1 nën paragrafi 1.2. dhe 1.4. të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, nenit 49 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3. të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenit 18 paragrafi 2 të Rregullores( QRK) NR. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik , nxjerrë këtë:

**VENDIM**

I. Znj. Njomza Haxhiu – Zyrtare për të hyra në zyrën për buxhet dhe financa në kuadër të UHZ-së, emërohet anëtare e komisionit për shqyrtimin e ankesave për nëpunësit e shërbimit publik në kuadër të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë .

II. Ky emërim është i vlefshëm deri në kthimin e anëtares së komisionit për shqyrtimin e ankesave për nëpunësit e shërbimit publik në kuadër të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, Znj. Diliko Kaçi nga pushimi i lehonisë.

III. Emërimi i znj. Njomza Haxhiu bëhet për shkak se znj. Afrodita Gashi – Zv. Drejtor i Zyres për BNJ dhe BGJ është anëtare e komisionit disiplinor, kurse zyrtarja e personelit znj. Diliko Kaçi është në pushim të lehonisë.

IV. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

*BHasani*

U.d. Sekretare e Përgjithshme
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartëpërmendurës, Anëtarëve të komisionit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, zv. Drejtorit për BNJ dhe BGJ, Kryesuesit për Teknologji të Informacionit, Arkivit të Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 2558 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 26.10.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" UNIVERSITY PEJË MMXI-2011

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**Pejë, 26.10.2022**

Në bazë të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 41 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka " në Pejë, kërkesës nr. 2361 dt. 10.10.2022 për angazhimin e zyrtarëve për sigurim të cilësisë, si dhe me qëllim të caktimit të personit përgjegjës për punë shtesë për pozitën Zyrtar për Sigurim të Cilësisë në njësinë akademike në Fakultetin e Agrobiznesit, nxjerr këtë:

**VENDIM**

I. Znj. Florjana Zogaj zyrtare për protokol dhe arkivë në njësinë akademike në Fakultetin e Agrobiznesit angazhohet si staf mbështetës në zyren për sigurim të cilësisë në njësinë akademike në Fakultetin e Agrobiznesit.

II. Angazhimi në punë shtesë bëhet sipas kërkesës nr. 2361 dt.10.10.2022, me arsyetim të nevojës emergjente dhe mungesës së stafit të rregulltë në zyrën për sigurim të cilësisë në njësinë akademike në Fakultetin e Agrobiznesit.

III. Angazhimi në punë shtesë do të filloj prej dt. 27.10.2022 deri në rekrutimin e zyrtarit përkatës të përcaktuar me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, por jo më shumë se gjashtë (6) muaj.

IV. Gjatë kryerjes së punës shtesë për orët e punës jashtë orarit, e lartpërmendura do të kompenzohet sipas legjislacionit në fuqi.

V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Sipas kërkesës nr. 2361 dt.10.10.2022 për angazhimin e një zyrtari administrativ të rregullt në cilësinë e Zyrtarit për Sigurim të Cilësinë në njësinë akademike në Fakultetin e Agrobiznesit, për shkak se detyrat e këtij pozicioni nuk janë të mbuluara aktualisht nga asnjë zyrtar ndërsa kjo pozitë është më se e nevojshme në mënyrë që procesi i punës të bëhet pa ngecje, ku Universiteti është në vitin e aplikimit për riakreditim institucional në Agjencinë e Kosovës të Akreditimit dhe mos ushtrimi i detyrave në këtë zyrë do të shkaktojë probleme serioze në realizimin e punëve të kësaj zyre në procesin e riakreditimit institucional, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

U.d. Sekretare e Përgjithshme

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

Hasani

UNIVERSITETI HAXHI ZEKA SEKRETARI I PËRGJITHSHËM PEJË

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurës, Dekanit të F. Agrobiznesit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Sekretarit të njësisë akademike, Zyrës për sigurim të cilësisë dhe vlerësim, Zyres për BNJBGJ, Arkivit të Universitetit.

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 3129 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date: 30.11.2022 Pejë / Peć

Pejë, 30.11.2022

Në bazë të nenit 59 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 41 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka " në Pejë, nenit 11 paragrafi 4 të Rregullores nr.12/2020 për orarin e punës dhe pushimet e zyrtarëve publikë, si dhe raportit mjeksor dt.29.11.2022, nxjerr këtë:

## VENDIM

I. I lejohet pushimi një (1) mujor me kompensim prej 70 % të pagës, znj. Myhybije Zhallqi Zhara, Zyrtare për çështje studentore në njësinë akademike në Fakultetin e Agrobiznesit.

II. Pushimi një (1) mujor me kompensim prej 70 % të pagës, vlenë nga dt. 01.12.2022 deri me dt. 30.12.2022.

III. Obligohet zyra për financa dhe buxhet që pagesa prej 70% të pagës të bëhet brenda afatit kohor të paraparë në pikën II të këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Duke u bazuar në raportin mjeksor të dt. 29.11.2022 dhe nenin 11 paragrafi 4 të Rregullores nr. 12/2020 për orarin e punës dhe pushimet e zyrtarve publik ku ceket se: "Zyrtari publik ka të drejtë në kompensim të pushimit mjeksor si pasojë e lëndimit në punë ose sëmundjes profesionale të ndërlidhur me kryerjen e punëve dhe të shërbimeve për institucionin deri në nëntëdhjetë (90) ditë me kompensim prej 70 % të pagës së tij" , u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

U.d. Sekretare e Përgjithshme

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

B.Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurës, Dekanit të F. Agrobiznesit, Prorektore për Buxhet dhe Financa, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Sekretarit të njësisë akademike, Drejtorit per Financa dhe Buxhet, Zyrtarit për paga , Zyres për BNJBGJ, Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 3145 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 01/12/2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Pejë, 01.12.2022

Në bazë të nenit 41 të Statut të Universitetit "Haxhi Zeka " në Pejë, si dhe me qëllim të caktimit të personit përgjegjës për punë shtesë për pozitën e Zyrtarit për paga në Zyren për buxhet dhe financa në kuadër të UHZ, nxjerr këtë:

**VENDIM**

I. **Autorizohet: z. Muhamet Muriqi** – që përveç detyrave të parapara si Zyrtar shpenzues, nga dt. 01.12.2022, si punë shtesë t'i kryej edhe detyrat e zyrtarit për paga në Zyren për buxhet dhe financa në kuadër të UHZ

II. Vendimi është i vlefshëm deri në marrjen e një vendim tjetër.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Për arsye se z . Armend Alimusaj me pozitë zyrtar për paga në Zyren për buxhet dhe financa në kuadër të UHZ, sipas vendimit nr.2418/22 dt. 12.10.2022 është emëruar zv. Drejtor i Administratës Qendrore dhe për shkak se detyrat e këtij pozicioni nuk janë të mbuluara aktualisht nga asnjë zyrtar, zyrtari shpenzues në Zyren për buxhet dhe financa në kuadër të UHZ, **z. Muhamet Muriqi** autorizohet që përveç detyrave të parapara si zyrtar shpenzues në zyrën për buxhet dhe financa, nga dt. 01.12.2022, si punë shtesë t'i kryej edhe detyrat e zyrtarit për paga në kuadër të zyrës së financave , deri në marrjen e një vendimi tjetër .

Andaj, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

U.d. Sekretare e Përgjithshme

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

BHasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurit, Drejtorit për buxhet dhe financa, Prorektores për buxhet dhe financa, U.d. Sekretares së Përgjithshme, Menaxheres së Burimeve Njerëzore, Arkivit të Universitetit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 3377 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 28.12.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**Datë: 28.12.2022**

Duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-042, për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092, nenin 183 të Statutit Nr. 04 – V – 662 të Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë, si dhe nenin 40 të Rregullores nr.82/22 për Prokurimin Publik, Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) i Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë (UHZ) në bashkëpunim me Drejtorin e Departamentit të Prokurimit me dt. 28.12.2022, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I.** Mbi themelimin e Komisionit RI - Vlerësues për tenderin: **Rregullimi Infrastrukturor në Objektet e Universitetit me nr. të prokurimit uhz-22-7429-5-2-1.**, në përbërje të:

1. Veton Jahmurataj / Kryetar;
2. Muhamet Jupa/ Anëtar;
3. Meriton Fetaj / Anëtar;

**II.** Detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë e komisionit janë të përcaktuara në Rregulloren për Prokurimin Publik.

**III.** Anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësishtë dispozitave të LPP në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.

**IV.** Zyrtari përgjegjës i Prokurimit do të udhëheq komisionin vlerësues të tenderit pa të drejtë vote.

**II.** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga ana e ZKA-së.

**A r s y e t i m**

Departamenti i Prokurimit i UHZ-së më datë 10.08.2022, ka hapur ofertat lidhur me njoftimin e shpallur për kontratë për tenderin me titull: Rregullimi Infrastrukturor në Objektet e Universitetit me nr. të prokurimit uhz-22-7429-5-2-1, mirëpo duke u bazuar në Vendimin nr. 538./22 dt.23.12.2022 të Organit shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

U.d. Sekretare e Përgjithshme

BHasani

UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" SEKRETARI I PËRGJITHSHËM GENERALNI SEKRETAR PEJË

**Vendimi t'i dërgohet:** U.d. Sekretarit të Përgjithshëm, Prorektores për buxhet, financa dhe infrastrukturë, Drejtorit të Prokurimit, Anëtareve të Komisionit Vlerësues, Asistentes së Rektorit, Arkivit të Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 045 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 2

Data / Datum / Date: 14.01.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**Dt. 14/01/2022**

Në bazë të nenit 38, dhe 41, të Statutit të Universitetit me Nr.04-V-622, nenin 11 paragrafi 2 i Ligjit-Nr.06/L-081, Për Qasje në dokumentet publike, si dhe kërkesës së parashtruar me nr.protokoli 5185 dt. 13 Janar 2022, U.d. Sekretari i Përgjithshëm nxjerr këtë:

**VENDIM**

I. Gazetës KALLXO.com – i lejohet qasja në dokumentet publike, sipas kërkesës së datës 13 Janar 2022.

II. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë do të ndihmon kërkuesin, aq sa është e mundshme në bazë të arsyeshmërisë, të identifikojë dokumentet e kërkuara.

III. Obligohet që kërkuesi për qasje në dokumentet e kërkuara që ti përmbahet dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Ky vendim lëshohet duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 2,të Ligjit-Nr.06/L-081 për qasje në dokumentet publike, ku pala kërkuese është e obliguar që gjatë konsultimit apo përdorimit të dokumentacionit të lejuara t'i përmbahet pikës III të këtij vendimi.

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

BHasani

U.d. Sekretar i Përgjithshëm
Universiteti "Haxhi Zeka" – Pejë

**Vendimi t'iu dërgohet:** Palës, Zyrës së Rektorit, U.d. Sekretarit të Përgjithshëm, Drejtorit për Buxhet dhe Financa dhe Arkivit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 051 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 3

Data / Datum / Date: 17 01 2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Pejë, 17.01. 2022

Në bazë të nenit 41 të Statutit nr.04-v-622 të UHZ-së, nenit 51 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2. të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Vendimit nr. 112-44882/21 dt.22.12.2021, si dhe kërkesës nr. 3449/21 dt. 23.12.2021 U.d. Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit "Haxhi Zeka ", nxjerr këtë:

**V E N D I M**

I. Aprovohet si e bazuar kërkesa nr. 049/22 dt. 14.01.2022, e z. Agron Halitaj, Zyrtar për Buxhet dhe Financa në NA/ Fakulteti i Biznesit në UHZ, për pezullim të marrëdhënies së punës.

II. Periudha e pezullimit të përkohshëm të marrëdhënies së punës është prej dt. 14.01.2022.

III. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Pas shqyrtimit të kërkesës nr. 049/22 dt. 14.01.2022, të z.Agron Halitaj, Zyrtar për Buxhet dhe Financa në NA/ Fakulteti i Biznesit në UHZ, për pezullim të marrëdhënies së punës, Vendimit Nr.Prot: 01/112/04/45/3/2022, për emërimin e Drejtorit të Drejtorisë për Inspektorat në Komunën e Pejës, me të cilin i lartpërmenduri emërohet, Drejtor i Drejtorisë për Inspektorat në K.K. Pejë, nga data 13.01.2022, si dhe nenit 51 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2. të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës ku parashihet pezullimi i përkohshëm i të drejtave dhe detyrave nga marrëdhënia e punës kur zgjidhet apo emërohet në funksione publike, konstatoi se kërkesa e të lartpërmendurit është e drejtë dhe e bazuar në gjendjen faktike.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

U.d. Sekretare e Përgjithshëm i Universitetit

LL.M. Tirana Baftiu – Hasani

B.Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Rektorit, U.d. Sekretares së Përgjithshme, të lartpërmendurit, Menaxheres së Personelit, Drejtorit për buxhet dhe financa, Zyrtarit për paga ,Arkivit të Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 052 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date: 17.01.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Pejë, 23.12. 2021

Në bazë të nenit 38 paragrafi 3 të Statutit nr. 04-V-622 të UHZ-së, dhe pikës III. të vendimit nr.6476/21 të KPMSHCK, Ud. Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit "Haxhi Zeka " nxjerr këtë:

## VENDIM

I. Anulohet vendimi me nr. 098 dt.23.01,2020 i Komisionit Disiplinor dhe Vendimi nr.627 i dt, 16.03.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të UHZ- në Pejë.

II. Znj. Mimoza Nurboja – Zyrtare për Master dhe Doktoratur në NA /Fakultetin e Biznesit , i heqet nga dosja personale masa e shqiptuar disiplinore.

III. Obligohet Zyra për buxhet dhe financa që Znj. Mimoza Nurboja t'i bëhet rimbursimi i mjeteve financiare të ndaluara sipas vendimit nr. 098 të dt.23.01.2020.

IV. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Me dt. 14.01. 2022 Universiteti "Haxhi Zeka " në Pejë ka pranuar Vendimin me nr. 6476/21 të KPMSHCK, sipas të cilit U.d. Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit është obliguar që nga dita e pranimit të vendimit të ndërmarr të gjitha veprimet administrative për zbatimin e Vendimit të lartëcekur.

Andaj, duke u bazuar në pikën III të vendimit nr.6476/21 të KPMSHCK u vendos si në dispozitiv

U.d. Sekretar i Përgjithshëm i Universitetit
LL.M. Tirana Baftiu – Hasani
T.B.Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:** Zyres së Rektorit, U.d. Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit, të lartpërmendurës, Zyres së Personeli, Drejtorit për buxhet dhe financa, Arkivit të Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë.

Adresa: Rr. " UÇK" 30000, Pejë
www.unhz.eu; info@unhz.eu.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 055 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 2
Data / Datum / Date: 17.01.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

**Vendim /MK/** /Datë: 17.01.2022

Duke u në bazuar në nenin 59 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 04/L-042, për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, nenin 183 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë Nr. 04 – V – 662 të datës 30 Maj 2013, si dhe duke u bazuar në Rregulloren për Prokurimin Publik AU01 neni 40, Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) i Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë (UHZ) në bashkëpunim me Drejtorin e Departamentit të Prokurimit me 17 .01. 2022, nxjerr këtë:

**VENDIM**

**I.** Mbi themelimin e Komisionit Vlerësues për tenderin: **Shërbimet e përkthimit për nevojat e UHZ,** Nr. i prokurimit: **uhz-22-17-2-2-1.**

**II.** Sipas këtij vendimi caktohet komisioni përkatës në përbërje të:
- Osmon Sejfijaj -Drejtor për Administratës në UHZ / Kryetar;
- Veton Jahmurataj – Drejtor për Bibliotek në UHZ / Anëtar;
- Meriton Fetaj - Zyrtar për çështje studentore / Anëtar;

**III.** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga ana e ZKA-së.

**Arsyetim**

Departamenti i Prokurimit i UHZ-së më datë 17.01.2021, ka hapur ofertat lidhur me njoftimin e shpallur për kontratë për tenderin me titull : **Shërbimet e përkthimit për nevojat e UHZ ,** Nr. i prokurimit: **uhz-22-17-2-2-1.**

Detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë e komisionit janë të përcaktuara në Rregulloren për Prokurimin Publik A01, neni 41, të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësishtë dispozitave të LPP në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të biznesit.

Zyrtari i Prokurimit dhe/ose anëtarët e stafit përgjegjës të Departamentit të Prokurimit, sipas nenit 16 të Rregullores për Prokurimin Publik A01, nuk do të shërbejnë si anëtarë të komisionit vlerësues. Zyrtari përgjegjës i Prokurimit do të udhëheq komisionin vlerësues të tenderit pa të drejtë vote. Ai/ajo do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP.

Prandaj, duke u bazuar si në dispozitiv të këtij Vendimi, është themeluar Komisioni për Vlerësimin e Ofertave.

**Shqyrtimi i Bazës Ligjore:**

- Ligji Nr. 02/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092;
- Rregullorja për Prokurimin Publik A01;

U.d. ZKA i Universitetit

LL.M. Tirana Baftiu Hasani

B.Hasani

**Vendimi t'i dërgohet:**
U.d. ZKA , Drejtorit të Prokurimit, Anëtareve të Komisionit Vlerësues, Asistentes së Rektorit, Arkivit të Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 119 | Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date: 26.01.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Në mbështetje të nenit 38 paragrafit 3 të Statutit Nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka " Pejë, dhe nenit 17 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nxjerrë këtë:

**VENDIM**

I. Nëpunësja Znj. Mimoza Nurboja e cila aktualisht është Zyrtare për Master dhe Doktoratë në njësinë akademike/ Fakultetin e Biznesit në UHZ-së, sistemohet në pozitën Zyrtare për Master dhe Doktoratë në njësinë Akademike / Fakultetin e Menaxhimit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis.

II. E lartëcekura është e obliguar që t'i përmbushë të gjitha të drejtat dhe detyrimet si Zyrtare për master dhe doktoratë, sipas përshkrimit të vendit të punës të parapara me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në UHZ-së.

III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Për shkak të ristrukturimit të punës në Fakultetin e MTHM-së, dhe duke pasur parasysh se pozita është e lirë dhe e zbrazët, si dhe detyrat e këtij pozicioni janë mbuluar nga zyrtarët e Fakultetit të Biznesit, sistemimi i nëpunëses Znj. Mimoza Nurboja e cila aktualisht është Zyrtare për Master dhe Doktoratë në njësinë akademike/ Fakultetin e Biznesit në UHZ-së, bëhet në pozitën Zyrtare për Master dhe Doktoratë në Njësinë Akademike - Fakultetin e Menaxhimit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis.

Sistemimi bëhet duke u bazuar në nenin 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ku citohet se : " Në rast të nevojës për ristrukturim apo organizim të ri të punës, i punësuari në pajtim me Kontratën e Punës mund të sistemohet në vend tjetër të punës që i përgjigjet përgatitjes profesionale, aftësisë së tij dhe nivelit të njëjtë të pagës, në pajtim me Kontratën e Punës", si dhe duke pasur parasysh se në Fakultetin e MTHM- së, ka nevojë për një Zyrtar për master dhe doktoratë në mënyrë që procesi i punës në këtë njësi akademike të bëhet në mënyrë permanente dhe pa ngecje.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**LL.M. Tirana Baftiu Hasani – U.d. Sekretar i Përgjithshëm/ UHZ-së**

**Nënshkrimi** ____BHasani____

**Data 26/01/2022**

**Vendimi t'i dërgohet:** Të lartpërmendurës, U.d. Sekretarit të Përgjithshëm, Dekanit të Fakultetit të MTHM-së, Sekretares së njësisë së Fakultetit të MTHM-së, Departamentit për Buxhet dhe Financa, Menaxheres së Burimeve Njerëzore, Kryesuesit për teknologji të informacionit, Udhëheqësit të Sektorit të Arkivit.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË

REKTORATI

Nr. / Br. / No. 240 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1

Data / Datum / Date 10.02.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, dhe kërkesës së datës 07.02.2022, nxjerr:

## VENDIM
## Për caktimin e zyrtarit/es

1. **Znj. Valmire Abazi,** zyratr për Zotime, Buxhet dhe Financa, i jepet qasja në Sistemin e SIMFK-së në modulin e obligime/kërkesë për blerje, në nivel të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Kodi organizativ 208, Kodi i programit 97400.

2. E lartëpërmendura me qasjen për regjistrimin e obligimeve dhe kerkesave për blerje në SIMFK, për vitin 2022.

3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë si dhe kërkesës së datës 07.02.2022 për dhënie të qasjes në sistemin e SIMF-së, për modulin e obligime/kërkesë për blerje, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Vendimi u dërgohet:**

1. Valmira Abazi,
2. Zyrës për Burime Njerëzore,
3. Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm,
4. Arkivit.

Tirana Baftiiu – Hasani
U.d. Sekretar i Përgjithshëm

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI
UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"
PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 241 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 1
Data / Datum / Date: 10.02.2022 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, dhe kërkesës së datës 07.02.2022, nxjerr:

## VENDIM
## Për caktimin e zyrtarit/es

1. **Znj. Diana Shala,** drejtor për Buxhet dhe Financa, i jepet qasja në Sistemin e SIMFK-së në modulin për pamje dhe raportim e SIMFK-së, në nivel të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Kodi organizativ 208, Kodi i programit 97400.

2. E lartëpërmendura me qasjen për pamje dhe raportim ka mundësinë t'i shohin të gjitha të dhënat në të gjitha modulet e SIMFK-së, për vitin 2022.

3. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Duke u mbështetur në dispozitat e cekura më lartë si dhe kërkesës së datës 07.02.2022 për dhënie të qasjes në sistemin e SIMF-së, për modulin pamje dhe raportim, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Vendimi u dërgohet:**

1. Diana Shala,
2. Zyrës për Burime Njerëzore,
3. Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm,
4. Arkivit.

B. Hasani

Tirana Baftiiu – Hasani

U.d. Sekretar i Përgjithshëm